

Barbara Pappas

A je i shpëtuar?

Procesi i Shpëtimit në Kishën Orthodhokse



ROTIMET "NGJALLJA"

TIRANË, 2017

Botohet me bekimin
e Kryepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe të Gjithë Shqipërisë,
† Anastasit

Titulli i origjinalit: Are you saved?
The Orthodox Christian Process of Salvation
By Barbara Pappas

© Barbara Pappas, 1984, 1986, 1995, 1997

Library of Congress Catalog Card Number 95-79640

ISBN 0-9623721-4-5

Botuar në disa gjuhë: koreane 2002 , frëngjisht, greqisht, serbisht,
rusisht, arabisht, spanjisht 2013 dhe shqip 2017.

Amnos Publication
Holy Apostles Greek Orthodox Church
2501 South Wolf Road Westchester, Illinois 60154 (708) 562-2744
Fax: (708) 562-2752
Email: ayspappas@msn.com

© Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë

ISBN: 978-9928-4377-5-4

PËRMBAJTJA

Hyrje	5
<u>Hapi i parë: Beso.</u>	9
Ikona e Lindjes së Zotit Krisht: <i>Kjo ikonë thekson hapin e parë në procesin e shpëtimit.</i>	
KAPITULLI I PARË	
PLANI HYJNOR I PERËNDISË	12
<u>Hapi i dytë: Provo besimin tënd</u>	31
Ikona e Katër Ungjillorëve: <i>Kjo ikonë thekson hapin e dytë në procesin e shpëtimit.</i>	
KAPITULLI I DYTË	
SEKRETI I SHPËTIMIT	33
<u>Hapi i tretë: Përballemi me Gjykimin</u>	53
Ikona e Krishtit Pantokrator: <i>Kjo ikonë thekson hapin e tretë në procesin e shpëtimit.</i>	
KAPITULLI I TRETË	
UDHA PËR NË MBRETËRI	56

<u>Hapi i katërt: Mbretëria e Perëndisë</u>	77
Ikona e Zbritjes së Krishtit në Hadh: <i>Kjo ikonë thekson hapin e katërt në procesin e shpëtimit.</i>	
Epilog	80



HYRJE

Kohët e fundit vihet re një numër gjithnjë e në rritje i besimtarëve orthodhoksë, të rinj e të vjetër, që vazhdojnë të diskutojnë hapur një temë e cila është shmangur për një kohë të gjatë. Gjatë mësimëve të katekizmit, në grupet e studimeve biblike dhe në ato të lutjes shtrohen vazhdimisht pyetje të tilla, si: Si të shpëtoj? Çfarë nënkupton shpëtimi? Çfarë duhet të bëj që të shpëtoj? Interesimin për këtë çështje e kam parë gjithmonë në rritje, dhe shqetësimin për të e kam gjykuar si shenjë të rritjes shpirtërore. “E gjithë krijesa psherëtin”, që të mësojë të vërtetën.

Diskutimet më të shumta lidhen me Protestantizmin dhe me të krishterët e “lindur sërish”. Relativisht, deri më tani, pjesa më e madhe e besimtarëve tanë i shmangin këto lloj bisedash për arsye të mungesës së njohurive për temën e shpëtimit. Kjo temë nuk është e re për besimin tonë. Studimi i Historisë së Kishës dhe betejat e ndryshme të Etërve të Kishës së hershme na tregojnë se pyetja “Si të shpëtojmë?” tingëllonte po kaq aktuale në kohën e Joan Gojartit, Grigorit të Nisës dhe të të tjerëve, aq sa edhe sot.

Ky studim do të ndihmojë çdokënd që e lexon, për të pasur njohuri për shpëtimin me anë të Jisu Krishtit dhe për të qenë i aftë ta diskutojë atë me të tjerët. Është një përpjekje për të marrë përgjigje dhe për ta kuptuar këtë temë, e cila bëhet gjithmonë e më e rëndësishme. Për më tepër është një vepër dashurie nga një mësuese e besimit, e cila është përballur personalisht me këtë çështje dhe që është ftuar nga kolegët e studentët e saj për t'iu dhënë përgjigje dhe udhëzime. Ky nuk është manual përfundimtar, por një dritare nëpërmjet së cilës shpirti i trazuar mund të drejtohet te limani i së vërtetës dhe te të kuptuarit e shpëtimit.

Autorja Barbara Pappas u motivua ta përgatiste këtë studim, sepse ishte shqetësuar për shpëtimin, jo vetëm të shpirtit të saj, por edhe të vëllezërve dhe motrave të tjera. Stareci Zosima i Dostojevskit te *Vëllezërit Karamazov*, i afrohet së vërtetës kur thotë se secili nga ne është “përgjegjës për çdonjërin dhe për çdo gjë”.

Barbara Pappas ka shërbyer si mësuese në shkollën e së dielës (katekizëm) dhe si drejtoreshë e kurrikulës në shkollën e kishës së Apostujve të Shenjtë në Uestçester, Ilinois. Për shumë vjet, gjatë kësaj kohe, ajo ka punuar me mësuesit, prindërit dhe të rinjtë e të gjitha moshave. Tani është anëtare e Komisionit të Edukimit Fetar në Mitropolinë Orthodhokse Greke të Çikagos dhe ofron Studime Biblike për të rriturit në kishën e Apostujve të Shenjtë. Ajo i mblodhi këto përvoja dhe

kreu këtë studim të pasur e lutësor. Të gjithë ata që kanë pasur mundësinë ta takojnë, kanë përfituar nga dashuria e saj rrezatuese për Kishën, nga besimi i saj i palëkundur te Jisu Krishti si Mesia i premtuar, nga të kuptuarit e saj të thellë të Besimit Orthodhoks dhe nga dëshira e paepur për t'u treguar të tjerëve të vërtetat e zbuluara. Është privilegj dhe kënaqësi e veçantë ta quaj një nga shërbëtoret besnike të Kishës së Krishtit.

Ritheksojmë mirënjohjen për prezantimin fillestar të librit, në të cilin patëm mbështetjen e pakufizuar nga i ndjeri Kryepiskopi Jakov i Amerikës së Veriut dhe të Jugut, po ashtu edhe nga Mitropoliti shumë i dashur, Jakovi i Çikagos, Mitropoliti Isaia i Denverit dhe nga drejtues të tjerë fetarë, të cilët e kanë miratuar këtë tekst që në fillim dhe vazhdojnë ta mbështesin.

Ia rekomandoj këtë libër kujtdo që ka etje për njohuri dhe për të vërtetën orthodhokse. Unë besoj se do të ndihmojë për studime vetjake, për diskutime në mësimet e katekizmit dhe për grupet e studimeve biblike. Lexojeni tekstin deri në fund dhe më pas kthehuni te pjesët që ju interesojnë më shumë. Ky libër mund t'ju ofrojë shumë për t'u pasuruar dhe për të kuptuar të përjetshmen dhe Besimin e çmuar Orthodhoks.

*Atë Uilliam S. Chiganos
Kryetar i Komisionit të Edukimit Fetar
në Mitropolinë e Çikagos*

A JE I SHPËTUAR?



Hapi i parë: Beso

IKONA E LINDJES SË ZOTIT JISU KRISHT



*Pikturë murale në kishëzën e Lindjes së Krishtit,
pranë Katedrales Orthodhokse “Ngjallja e Krishtit”, Tiranë
(K. Papanikolaou 2015).*

Kjo ikonë thekson hapin e parë në procesin e shpëtimimit: Ne duhet të “Besojmë” se Jisu Krishti është Mesia, i Cili, me ardhjen e Tij në tokë, përmbushi të gjitha profecitë dhe premtimet e Dhiatës së Vjetër. Ai mundi Djallin dhe siguroi *Udhën* për në Mbretërinë e Përjetshme të Perëndisë.

Ç'të të blatojmë, o Krisht, që u duke mbi dhé si njeri për ne; se cilado nga krijesat e bëra prej Teje të sjellë përhirim: Engjëjt - himnin, qiejt - yllin, Magët - dhuratat, barinj të - çudinë, dheu - shpellën, shkretëtira - grazhdin, dhe ne nënën Virgjëreshë; o Perëndi që je para jetësh, mëshirona.

Nga Mbrëmësorja e Vigjiljes së Krishtlindjes

Nëpërmjet tri yjeve, një në anën e përparme të mbulesës së kokës dhe një në secilën shpatull, ikonografia orthodhokse shpreh faktin se Maria është gjithmonë e virgjër, para, gjatë ngjizjes së Krishtit dhe pas lindjes së Tij. Me anë të ndërhyrjes hyjnore Virgjëresha lindi Mesian si përmbushje e profecive. Ai mori trup që të na shpëtojë nga kurthet e djallit, i cili na jepet në anën e poshtme, në të majtë të ikonës së Lindjes së Zotit Krisht me veshjen e një bariu që përpiket t'i vendosë dyshime në mendje Josifit, se cili mund të ishte i ati i fëmijës. Errësira e shpellës në të cilën lindi Krishti, simbolizon ligësinë e botës në të cilën Ai erdhi dhe solli dritën e së vërtetës.

Ejani të ngazëllohemi në Zotin duke treguar këtë mister. U prish muri që ndau Perëndinë nga njeriu. Shpata e flaktë u hoq nga porta e Edenit; Keruvimët u larguan nga druri i jetës; dhe unë, që u dëbova prej mosbindjes sime, tani kremtoj në dëfrimet e Parajsës: Sepse sot ikona e përsosur e Atit, e vulosur me vulën e përjetësisë së Tij, ka marrë formën e një

shërbëtori. Ai lindi prej një nëne të pamartuar, pa pësuar ndryshim; Ai është Perëndi i vërtetë dhe mbeti Ai që ishte, por nëpërmjet dashurisë së Tij për njerëzimin, u bë Ai që nuk ishte më parë: njeri i vërtetë! Ejani, o besnikë, le t'i thërresim Atij: O Perëndi, që linde prej Virgjëreshe, mëshirona.

Nga Mbrëmësorja e Vigjiljes së Krishtlindjes



Kapitulli i parë

PLANI HYJNOR I PERËNDISË

Nëse dëshira për Mbretërinë Qiellore djeg në shpirtin tënd si një pishtar i ndezur, ji i sigurt se shpirti yt do të bëhet shpejt trashëgimtar i saj, na thotë Ava Ipereku.

Arkimandrit Krisostomi

Etërit e Shkretëtirës

A JE I SHPËTUAR?

Cila është përgjigjja e Kishës Orthodhoke për këtë pyetje kaq të rëndësishme? Shkrimi i Shenjtë na siguron bazat për përgjigjen që kërkojmë, por Shkrimet mund të keqkuptohen. Kisha historike e adresoi këtë problem duke mbrojtur, për të gjithë brezat, të vërtetat e përjetshme të marra nga Krishti dhe Apostujt. Për të kryer këtë punë të shenjtë, ajo u mbështet në shkrimet e Etërve të Kishës së Hershme, vendimet e Sinodeve (të cilat i refuzuan herezitë), në Tekstet Liturgjike, Himnologji dhe në Ikonografi. Si në çdo kërkim për të vërtetën teologjike, udhërrëfyesi ynë është miratimi i përbashkët, i zbuluar në këto thesare.

Dhiata e Vjetër thotë se *në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën dhe çdo gjë të dukshme e të padukshme. Dhe për të gjitha këto që kishte bërë Perëndia pa që kjo ishte e mirë* (Gjeneza 1:25). Për shkak të dashurisë së madhe që Ai ka, sepse Perëndia është dashuri, Ai dëshironte që njeriu të merrte pjesë në atë që Ai kishte krijuar. Por Perëndia nuk dëshironte ta rrethonte Vetën me robotë, krijesa që mund t'i përgjigjeshin vetëm të programuara. Sepse vetëm krijesa si Ai do të vlerësonin plotësisht mrekullitë që Ai kishte bërë. Ai krijoi burrin dhe gruan *sipas ikonës së Tij*, dhe me vullnet të lirë. Ai u dha pushtet mbi tokë dhe mbi çdo gjë të gjallë¹. Ajo që Ai kërkonte në këmbim ishte vetëm dashuria e tyre, e cila realizohet me vullnet të lirë si e vetmja gjë që mund të jepej me të vërtetë prej tyre.

Pastaj Zoti Perëndi mbolli një kopsht në Eden, në lindje, dhe vendosi në të njeriun (dhe gruan) që kishte formuar (Gjeneza 2:8). Kopshti ishte i përsosur. Perëndia eci me ta dhe foli me ta². Ata ishin të rrethuar nga mrekulli, bukuri dhe çdo gjë e mirë për t'u ngrënë dhe kishin pontencialin të rriteshin në marrëdhënie me Krijuesin e tyre³. Përgjatë rrugës kishin bekimin për të bërë punën e vërtetë, të kujdeseshin për kopshtin pa u sforcuar nga puna e rëndë dhe nga mërzia që e bëjnë jetën dhe punën

1 Gjeneza 1:28.

2 Gjeneza 3:8-9.

3 Atë Kallistos Ware: *Udha Orthodhokse*, fq. 66; Vep. 17:26, 27.

të pashpresë. Nuk kishte sëmundje për njeriun, për kafshët apo për bimët; nuk kishte pleqëri dhe vdekje, nuk ekzistonte asgjë që mund ta gjymtonte qetësinë e kopshtit dhe jetën e tyre. Që të plotësoheshin kushtet e përsosura për rritjen e të gjitha gjallesave, Perëndia siguroi një mjegull të vazhdueshme që dilte nga toka dhe që ushqente Kopshtin, dhe gjithçka ishte në harmoni të përkryer.

Sigurisht që Adami dhe Eva duhet të kenë treguar dashuri të madhe për Mirëbërësin shpirtmirë, por fjalët nuk mjaftojnë. Dashuria e vërtetë kërkon vepra. Kështu që Perëndia u dha liri Adamit dhe Evës që të vepronin ashtu siç dëshironin, por me një përjashtim: Për të treguar dashurinë e tyre dhe për t'i forcuar ata nëpërmjet disiplinës vetjake, Ai u tha atyre të mos hanin *nga pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes* (Gjeneza 2:17). Pastaj Ai lejoi Satanin që t'i tundonte.

Rezultatet ishin shkatërrimtare. Adami dhe Eva nuk e ruajtën dot urdhërimin e vetëm që iu dha, dhe iu dorëzuan së njëjtës formë lakmie e krenarie, e cila kishte shkaktuar rënien e Satanait nga Qielli⁴. Në vend që zemrat e tyre të ishin plot me dashuri dhe mirënjohje për të gjitha ato që Perëndia kishte bërë të mundura për ta, përkundrazi, tek ata u rrit ndjenja e lakmisë, që të ishin si Perëndia, pa kufizim. Duke mohuar përpjekjen

4 Isaia 14:12-21, Zbul. 12:7-12.

e vazhdueshme të bindjes dhe të rritjes në ngjashmërinë e Perëndisë, ata zgjodhën të zinin vendin e Tij me anë të mosbindjes, që të hiqnin Atë nga froni i Tij, gjë që është e pamundur.

Pema e Njohjes nuk ishte e ndaluar ngaqë Perëndia dëshironte ta tundonte njeriun... Do të ishte mirë nëse do të merrnin prej saj në kohën e duhur; sepse, sipas teorisë sime, Pema ishte plotësuese vetëm për ata që kishin arritur maturinë dhe jo për ata që ishin disi të thjeshtë dhe lakmitarë. Pikërisht ashtu sikurse nuk është i mirë ushqimi i fortë për ata që janë të dobët dhe kanë nevojë për qumësht.

(Shën Grigori i Nazianzit)

Pasoja e mosbindjes ishte vdekja. Adami dhe Eva u krijuan të jetonin përjetësisht, por tani Perëndia i veshi ata me *tunika lëkure* (Gjeneza 3:21), me vdekshmërinë, e cila do të vendoste kufizime në çdo gjë që ata dinin⁵. Pastaj i nxori nga Kopshti i Edenit dhe vendosi në lindje të tij Keruvimet që vërtisnin nga çdo anë një shpatë flakëruese për të ruajtur rrugën e pemës së jetës.

Që nga ajo kohë e në vazhdim, burri dhe gruaja e parë duhej të mbronin veten e tyre. Nuk ishin më në ambientin e mbrojtur të kopshtit, iu duhej të punonin

⁵ Panajotis Nellis: "Veshje lëkure", *Shenjtërimi në Krisht*, fq. 46-53.

shumë për ushqimin e tyre dhe të luftonin me gjembat e jetës; probleme të mundshme me motin, kafshët (që deri atëherë ishin miqtë e tyre), me njëri-tjetrin dhe çdo gjë tjetër që Djalli do t'u vendoste në udhën e tyre⁶. Ata duhej të luftonin kundër sëmundjes dhe së ligës. Në këtë gjendje, vdekja (*e cila përvihohej në horizont*) faktikisht do të ishte një bekim. Do të krijohej një hije në gëzimet e jetës, por do të vendoseshin barriera edhe ndaj pasojave të botës së rënë. Vuajtjet personale, si edhe mundësia e shkaktimit të vuajtjes të tjerët do të vazhdonin nga brishtësia e jetës dhe nga kufizimet e kohës. Meqenëse jemi pasardhës të Adamit dhe Evës, jemi trashëgimtarë të kushteve që ata sollën për “mëkatit origjinal” dhe për dëbimin nga parajsa⁷. Gëzimi i jetës është se ofrohet mundësia për t'u kthyer në stadin e bekuar që Adami dhe Eva humbën për të gjithë ne.

Shpëtimi është kthimi i sigurisë në jetën e përvetshme me Perëndinë në stadin idilik që e rrethon Atë. Jeta jonë tokësore është një dhuratë e çmuar, sepse na jepet mundësia e vetme që të ndihmojmë veten për këtë shpëtim. Megjithatë, premtimi i Perëndisë për ne, nuk është kopshti origjinal, por Qielli vetë, ku, në praninë e

6 Gjenezë 3:17-19.

7 “Kisha Orthodhokse gjithmonë e ka hedhur poshtë doktrinën e “mëkatit fillestar”, pikëpamjen që të gjithë njerëzit, jo vetëm që mbartin pasojat, por edhe fajin për mëkatit e Adamit dhe të Evës”. Kronk, fq. 45. Shiko Ware fq. 80-81.

Tij⁸, nuk do të ketë më tundim dhe nuk do të ketë më aftësi ose mundësi mëkati. Koha e provës dhe e ndarjes së atyre që e duan Perëndinë dhe atyre që nuk e duan, do të ketë një fund. Të humbasësh këtë mundësi për shpëtim, do të thotë ta dorëzosh veten në agoninë e një keqardhjeje të thellë⁹. Por keqardhja pas vdekjes nuk ka më vlerë. Ajo bëhet *krimbi që nuk vdes*” (Marku 9:46), *zjarri i pashuar* që konsumon (Mattheu 3:12).

PREMTIMET E PERËNDISË

Para se Perëndia t’i dëbonte Adamin dhe Evën nga Edeni, Ai u dha atyre profecinë e parë¹⁰ duke shfaqur dashurinë e Tij Atërore gjithmonë të qëndrueshme dhe me besim te njeriu, pavarësisht nga mëkatet e tij. Perëndia u premtoi se do të dërgonte Birin e Tij, Jisu Krishtin (*Fara e gruas*, Hyjlindësja, nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë), i Cili do ta çlironte njeriun nga pasojat e asaj që i bëri vetes, me nxitjen e Satanait. Krishti do të bënte betejë me djallin, autorin e mëkatit dhe atin e gënjeshtres¹¹. Satanai do ta luftonte vazhdimisht Krishtin, por, pavarësisht nga të gjitha përpjekjet e tij, djalli nuk do të

8 Zbulesa 21:3-4.

9 Nikolaos P. Vassiliadis: *Misteri i Vdekjes*, fq. 519-520.

10 Gjeneza 3:15.

11 Joani 8:44.

arrinte asgjë, vetëm do t'i shkaktonte plagë në *thembër* (me anë të Kryqëzimit). Në fund Krishti do të dilte fitimtar me një goditje fatale në *kokën* e Satanait (me anë të Ngjalljes së Tij). Ky premtim i Shpëtimtarit hyjnor do të bëhej në *plotësinë e kohës* (Galatianëve 4:4), pasi Perëndia t'i ketë dhënë njeriut një mundësi për të njohur nevojat e tij për një Shpëtimtar.

Për të bindur njeriun për nevojën e tij të madhe, Perëndia zbatoi Planin e Tij Hyjnor, i cili përmbante tri elemente kryesore¹², ku çdonjëri solli ata që ishin të gatshëm të vazhdonin rrugën e shpëtimit. Së pari, Ai themeloi BESËLIDHJEN GOJORE nëpërmjet Abrahamit, njerëzit e të cilit do të ishin njerëzit e Perëndisë, nëse do t'i bindeshin Atij¹³. Shenja e kësaj besëlidhjeje ishte rrethprerja dhe qëllimi i saj ishte të paraqiste nevojën se njerëzit e Perëndisë duhej të ishin ndryshe, të ndarë nga bota dhe të themelonin një komb (Izraelin) dhe një familje nga ai komb (familjen e Davidit), nëpërmjet së cilës do të vinte shpëtimi (Jisu Krishti). Megjithatë, në vend që t'i bindeshin Perëndisë, shumica e njerëzve të Abrahamit u larguan nga Ai; në vend që t'i sillnin paganët te Perëndia, ata u bashkuan me ta.

12 Atë George Nicozisin dhe Priftëresha Freida Upson: *Misteret i Kishës Orthodhokse*, fq. 7-10.

Historia e Dhiatës së Vjetër është historia e personave të zgjedhur gjatë rënieve të njëpasnjëshme të Izraelit. Në këtë kohë Perëndia shpëtoi “një mbetje”, pritja e duruar e të cilëve arriti një pastërti më të madhe... derisa pastërtia supreme e Virgjëreshës ishte e denjë për të lindur Shpëtimtarin e gjithë njerëzimit¹⁴.

Me kalimin e kohës, kur njeriu ishte gati, Perëndia, nëpërmjet Moisiut, ndërmori hapin tjetër, duke themeluar BESËLIDHJEN E SHKRUAR, “Ligjin”. Qëllimi i Ligjit të Moisiut ishte të përcaktonte mëkatën duke theksuar përsosmërinë që kërkohej për t’u kthyer në praninë e Perëndisë. Kjo përvojë i tregonte njeriut se ai asnjëherë nuk mund ta fitonte vetë shpëtimin¹⁵. Adami dhe Eva kishin vetëm një urdhërim për të zbatuar; tani ishin dhjetë¹⁶. Veç kësaj, kishte edhe 613 ligje¹⁷, ku çdonjëri duhej të zbatohet me përpikëri; të shkelje njërin, ishte sikur t’i shkelje të gjitha¹⁸. Çdo shkelje duhej të shlyhej me një ofertë ose sakrificë, për faktin se mëkati (i përcaktuar në këtë besëlidhje si thyerje e Ligjit)

13 Gjenezë 17:1-2.

14 Vladimir Lossky: *Theologjia Orthodhokse, Një paraqitje* fq. 86.

15 Romakëve 3:19-20.

16 Eksodi 34:27-28.

17 Shiko librat e Eksodit, Levitikut, Numrat dhe Ligjin e Përtërirë.

18 Ligj.Përt. 27:10, 26; Jakovi 2:10.

kërkonte shlyerje. Njeriu ishte kapur në një rreth të pafund; ai, në mënyrë të pashmangshme, do të shkelte një ligj, kështu do të sillte ofertën e kërkuar dhe, pas kësaj, sërish do të shkelte një ligj tjetër e kështu me radhë. Kjo përsëritje vazhdoi derisa, përfundimisht, Jisu Krishti ofroi Veten e Tij si sakrifica e fundit në emër të të gjithë njerëzimit¹⁹.

Perëndia u tha izraelitëve të ndërtonin një Arkë ku të vendosnin Pllakat mbi të cilat Ai kishte shkruar Dhjetë Urdhërimet, dhe një Tabernakull (më vonë u zëvendësua nga Tempulli) ku të vendosnin Arkën. Arka duhej të mbahej në pjesën e shenjtë të quajtur Vendi shumë i Shenjtë, ku Perëndia ishte i pranishëm midis njerëzve të Tij²⁰. Vetëm kryepriftërinjtë mund të hynin në të *Shenjtën e të Shenjtave*, dhe kjo vetëm një herë në vit, në ditën e shlyerjes, për të ofruar gjak sakrifikues, i cili parafiguronte gjakun shpërblyes që Krishti do të ofronte dhe të lypnin faljen për mëkatet e popullit²¹. Vendi Shumë i Shenjtë ndahej me një perde nga pjesa që quhej Vendi i Shenjtë²², ku priftërinjtë e Dhiatës së Vjetër i ofronin Perëndisë çdo ditë sakrificat e njerëzve në përputhje me Ligjin. Perdja midis Vendit të Shenjtë dhe vendit Shumë të Shenjtë simbolizonte barrierën që

19 1 Joani 2:2.

20 Eksodi 25:22.

21 Levitiku 16.

22 Eksodi 26:33.

njeriu kishte krijuar midis vetes dhe Perëndisë për shkak të mosbindjes²³.

Perëndia i lejoi njerëzit e Tij të ndienin mungesën e shpresës, duke u përpjekur të shpëtonin veten me anë të Ligjit, por Ai asnjëherë nuk i la të binin në dëshpërim. Përgjatë Dhiatës së Vjetër, Ai vazhdimisht u jepte atyre shenja dhe profeci rreth Ardhjes së Mesias, i Cili do t'i shpëtonte nga gjendja e tyre e tmerrshme dhe e vështirë.

NEVOJA E NJERIUT PËR NJË SHPËTIMTAR

Shkrimet na japin të dhëna se Enoku dhe Ilia u morën direkt në qiell, sepse ata i pëlqyen Perëndisë²⁴. Shën Joan Gojarti na rrëfen se Ilia ishte i përsosur, jo në kuptimin e plotë të përsosmërisë së Krishtit, por për kohën kur jetoi²⁵. Edhe pse jemi thirrur të gjithë të jemi të përsosur²⁶, shumë nga ne nuk godasin në shenjë, dhe mosgoditja në shenjë është edhe përkufizimi i mëkatit (*Greqisht, amartia - të humbasësh shenjën*).

Si pasojë kemi nevojë për një Shpëtimtar, një Ndërmjetues, që të bëjë për ne atë që ne nuk mund ta bëjmë dot për veten tonë. Pasi njeriut iu dha koha e mjaftu-

23 Hebrejve 9:1-15.

24 Gjenezë 5:24; Hebrejve 11:5; 2 Mbretërit 2:1-11.

25 M.F. Toal: *Predikimet e të Dielave prej Etërve të Mëdhenj* vol. 2, fq. 54-55.

26 Matheu 5:48.

eshme për ta kuptuar këtë fakt, Perëndia e mbajti premtimin e Tij: Ai dërgoi Birin e Tij, i Cili, në të dyja natyrat e Tij, Perëndi i vërtetë dhe njeri i vërtetë, bashkoi Qiellin me tokën²⁷ dhe u bë shkalla e ëndrrës së Jakovit, instrumenti me anë të të cilit mund të ngjitemi në qiell²⁸.

Zoti ynë jetoi një jetë të përsosur, duke përmbushur kushtin e bindjes që Perëndia pret prej atyre që dëshirojnë të jetojnë përjetësisht me Të. Kështu Ai përmbushi Ligjin dhe ligjërisht *fitoi* shpëtimin. Gjatë misionit të Tij në tokë, armiqtë e Tij u përpoqën ta vrisnin²⁹, por Ai bëri të dështojnë përpjekjet e tyre derisa të vinte ora e Tij³⁰. Satanai priste me padurim vdekjen e Birit të Perëndisë, por ishte e qartë se Krishti i zotëronte të gjitha sa do të ndodhnin. Në kohën e caktuar nga Perëndia, Krishti e dorëzoi vullnetarisht veten e Tij, sepse për këtë Ai kishte ardhur³¹. Por, duke përgatitur vdekjen e Krishtit, Satanai i kaloi kufijtë e tij dhe ra në një “grackë hyjnore”, në grackën që bëri vetë.

27 “Që të shpëtonte popullin e Tij, Krishti duhej të ishte perëndi-njeri, hyjnor dhe njerëzor. Ai duhej të ishte Perëndi, që të na shpëtonte, dhe njeri, që shpëtimi të kuptohej nga njerëzimi dhe jo vetëm nga Perëndia, vetëm nga lart, si një lloj shpëtimi magjik”. Episkop Gerasimos Papadopoulos: *Orthodhoksia: Besim dhe Jetë*, vol. 2, *Krishti në jetën e Kishës*, fq. 41.

28 Gjenezë 28:12-13; Joani 1:51.

29 Joani 7:30, 8:20; 10:31, 39.

30 Joani 17:1.

31 Joani 10:17-18.

“Në grepin e Hyjnisë së Tij, ana njerëzore e Krishtit është karremi; Djalli hedh veten mbi pre, por grepi e zë atë, ai nuk mund ta gëlltisë Perëndinë.” (Shën Grigori i Nisës³²)

Krishti kaloi nga vdekja, por ajo nuk mund ta mbante Atë, sepse Ai ishte i pamëkatshëm! Kështu Ai mposhti vdekjen dhe u ngjall me anë të fuqisë mbizotëruese të Perëndisë.

“Për aq kohë sa mëkati dënonte me vdekje vetëm fajtorin, asnjë ndërhyrje në të nuk ishte e mundur, duke parë se kishte drejtësi në të. Por kur ai i dha të njëjtin ndëshkim Atij, i Cili ishte i pafajshëm, i drejtë dhe i denjë për kurora nderi dhe himne lavdie..., atëherë ai u zhvesh nga fuqia e tij.” (Shën Kirili i Aleksandrisë³³)

Vdekja e Krishtit nuk ishte çmimi që Perëndia vendosi për shpëtimin e njeriut, përkundrazi, ishte pasojë e mëkatit të trashëguar nga të gjithë ata që jetuan pas Adamit dhe Evës. Duke u bërë njeri, Krishti gjithashtu,

32 Lossky: “Dogma Kristologjike”, Theologjia, fq. 114.

33 R. Payne Smith, përkth. “Mbi Mishërimin”, Komenti i Ungjillit sipas Llukait, shënimi 1, fq. 52.

mori me vetëdije edhe ato që trashëgonte njeriu, vuajtjen dhe vdekjen. Vdekja e atyre që jetuan para Krishtit ishte e justifikuar, sepse të gjithë kishin mëkatuar. Nuk kishte justifikim për vdekjen e Krishtit, por si një Qengj i përsosur sakrifikues³⁴, në mënyrë të vullnetshme, mori barrën e mëkateve të njeriut. Ndërsa jeta e Tij po shuhej në Kryq, qielli u errësua dhe toka u drodh. Spirali vertikal i njerëzimit kishte ndërruar drejtim. Perdja e Tempullit u nda më dysh, sepse vdekja shpëtimtare e Krishtit hoqi barrierën e mëkatit midis Perëndisë dhe njeriut, duke i dhënë njeriut edhe një herë tjetër hyrje te Perëndia³⁵.

“Për cilin u ofrua Gjaku që u derdh për ne, dhe për çfarë qëllimi u derdh ai Gjak i shkëlqyer dhe i çmuar i Perëndisë tonë, i Cili ishte edhe Prifti, edhe Therorja? Sepse ne mbahehim në skllavëri nga i ligu, të shitur nën zotërimin e mëkatit, duke marrë kënaqësinë e ligësisë. Por nëse çmimi i shpëtimit iu pagua atij që na mbante të lidhur, unë pyes, për cilin u ofrua ai gjak dhe pse? Nëse për të ligun, atëherë mjerë për humbjen e tij! Nëse hajduti merr, jo vetëm nga Perëndia, por edhe Perë-

34 Zanafilla 22:7-8; Eksodi 12:3-13; Levitiku 23:12; Isaia 53:7; Joani 1:29.

35 Mattheu 27:51-54; Luka 23:44-45.

ndinë vetë si një shpërblesë, do të ishte më e drejtë ta kishim ruajtur pagesën e një çmimi kaq të madh në këmbim të tiranisë së tij. Nëse ky çmim iu pagua së pari Atit, si u bë kjo? Sepse nuk ishim në skllavëri nga Ai. Dhe përsëri, përse Gjaku i Birit të Tij të Vetëmlindur do të pranohej nga Ati, i Cili nuk pranoi Isaakun kur iu ofrua nga ati i tij, por në fakt ndryshoi sakrificën, duke e zëvendësuar atë me një dash në vend të thetores së arsyeshme? (Gjeneza 22:13). Nuk vihet re që Ati e pranoi Atë, por Ai as nuk e kërkoi Atë, dhe as kishte nevojë për Të; por për arsye të Planit të Shpëtimit...” (Shën Grigori i Nazianzit³⁶)

Krishti kishte ngjallur edhe njerëz të tjerë përveç Llazarit, por ata do të përballeshin përsëri me vdekjen. Zoti ynë u bë fryti i parë i të vdekurve³⁷, sepse Ai nuk do të vdiste më. Pasi eci mbi tokë për 40 ditë, që apostujt dhe dishepujt e Tij ta shikonin, ta kuptonin që Ai ishte me të vërtetë gjallë përsëri dhe të ishin të sigurt se pas vdekjes ka jetë, Ai u ngjiti në Fronin e Tij, në të djathtë të Atit, atje ku Ai pret ata që e duan.

36 Toal: Mbi Pashkën e shenjtë”, vol. 2, fq. 257.

37 1 Korinthianëve 15:20.

BESËLIDHJA E GJAKUT, e treta dhe e fundit me Perëndinë, ishte themeluar si një përmbushje e Besëlidhjeve Gojore dhe të Shkruara para saj. Në përputhje me dispozitat e saj, ai që *beson* se Jisu Krishti është Biri i Perëndisë, pranon dhe rrëfen se Ai është Perëndia dhe Shpëtimtari i tyre, Mesia i Premtuar, i Cili siguroi udhën për në Mbretërinë e përjetshme, do të marrë dhuratën e Shpëtimit. Ata janë Izraeli i Ri, fara e adoptuar e Abrahamit nëpërmjet Krishtit (Galatianëve 3:29), të çliruar një herë e përgjithmonë nga pasojat e mëkatit³⁸, jo nga përpjekjet e tyre personale, por nga virtyti i të qenit pjesë e Krishtit nëpërmjet Pagëzimit, Eukaristisë dhe të një jete me besim. Kështu na jepet mundësia që të marrim pjesë në trashëgiminë e Tij, të fitojmë premtimet e Perëndisë³⁹.

BESIMI DUHET TË TREGOHET ME VEPRA

Është shumë e lehtë të thuash: “Unë besoj”. Por është shumë më tepër e vështirë të jetosh sipas besimit, ndaj kjo është prova e vërtetë. Edhe “djajtë besojnë” (Jakovi 2:19): ata e dinë se Perëndia ekziston dhe ka planin e Tij për krijimin, plan të cilin ata e kanë hedhur poshtë që në fillim. Prandaj Krishti tha: “*Nuk do të hyjë në mbretërinë e qiejve kushdo që më thotë: Zot, Zot; por ai që bën dëshirën e*

38 Hebrejve 9:14-15 (Lexo kap. 8-10).

39 Efesianëve 2:4-6; Galatianëve 4:4-7.

Atit tim që është në qiej (Mattheu 7:21). Në Shkrim shprehet shumë qartë se ne nuk duhet vetëm që ta pohojmë besimin dhe pas kësaj të ndihemi të sigurt për shpëtimin. Besimi duhet të tregohet nëpërmjet jetës së jetuar sipas fjalës së Perëndisë, *sepse besimi pa vepra është i vdekur* (Jakovi 2:20). Ata që e kundërshtojnë këtë, duke thënë se Perëndia e di nëse besojmë ose jo, dhe se nuk është e nevojshme ta “provojmë”, duhet të kenë parasysh fjalët e apostull Pavlit: *Shikoni veten tuaj, nëse jeni në besë; provoni veten tuaj; apo s’e njihni veten tuaj se Jisu Krishti është në ju? Veç në qofshi të pasprovuar në ndonjë gjë* (2 Korinthianëve 13:5).

“Çdo ditë dhe çdo orë, nga ne kërkohet që të dëshmojmë dashurinë tonë për Perëndinë. Sepse Perëndia, çdo ditë dhe çdo orë, dëshmon dashurinë e Tij për ne.” (Shën Isaak Siriani ⁴⁰)

Perëndia i njeh zemrat tona. Të shfaqësh besimin, është një kërkesë për përfitimin tonë dhe jo të Atij. Është bekim dhe jo barrë. Kjo na ndihmon të ruhem nga vetë-kënaqësia. Na drejton në vepra dhe na nxit të shkojmë drejt shenjtërisë, që të mund të ngrihemi mbi natyrën tonë njerëzore dhe të bëhemi *pjesëtarë të natyrës hyjnore*,

40 Nikolai Velimiroviç: *Prologu nga Ohrid*, Pjesa 1, fq. 296.

nëpërmjet përvetësimit të njohurisë, vetëkontrollit, durimit, shpresëtarisë, mirësisë dhe të dashurisë për të afërmin, si fryt i besimit tonë. Shkrimi i Shenjtë na siguron se, *nëse* marrim pjesë aq sa mundemi në këtë përpjekje për rritje shpirtërore, do të hyjmë në mbretërinë e përjetshme të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht (2 Pjetri 1:5-11).

Një igumen i ri i ditëve tona, mori këto këshilla nga një njeri i shenjtë: “Sot, shumë njerëz, duke dashur të gjejnë justifikim që të mos bëjnë atë që u kërkon Perëndia, ankohen për mësimet e Kishës së Shenjtë dhe mohojnë saktësinë e besimit të krishterë. Në vend të kësaj, zgjedhin të besojnë atë që dëshirojnë. Kjo është e ngjashme me një njeri që nuk dëshiron të besojë se ai do të vdesë, thjesht sepse kjo ide e bën të mos ndihet rehat. Ai, jo vetëm që nuk do të përgatitet për vdekjen, ashtu si duhet, por, në mënyrë të pashmangshme, do ta gjejë veten në grackën e saj. Besimi i saktë nuk bazohet tek ajo që do të dëshironim të ishte e vërtetë, por te vetë e Vërteta⁴¹.

41 Arkimadrit Krisostomos: *Etërit e hershëm të shkretëtirës*, fq. 66.

Leo i Madh

**KRISHTI SI PËRMBUSHJE E LIGJIT,
NJOHURI QË VAZHDON TË KETË VLERË PËR
ATA QË E DUAN ATË.**

Si rrjedhë, asnjë besimtari nuk i mohohen dhuratat e hirit, dhe askush midis tyre nuk është i panënshtuar ndaj rregullit të krishterë të jetës. Ndonëse u hoq ashpërsia e Ligjit simbolik, por përfitimi nga bindja e lirë e Ligjit është rritur, ashtu si Joan Ungjillori thotë: “Sepse Ligji u dha nëpërmjet Moisiut, por hiri dhe e vërteta erdhën nëpërmjet Jisu Krishtit (Joani 1:17). Sepse çdo gjë që i përkiste Ligjit, rrethprerja ose ofrimet e ndryshme apo respektimi i Sabatit, të gjitha jepnin dëshmi për Krishtin, dhe parathanë hirin e Krishtit.

Dhe Ai është fundi i Ligjit (Romakëve 10:4), jo se Ai e shpërfill atë, por se Ai e përmbush. Ndonëse Ai është Autori i të dyjave, si i së Vjetrës ashtu dhe i së Resë, Ai i dha fund rëndësisë mistike të figurave dhe të premtimeve, se Ai i përmbushi premtimet dhe bëri që profecitë të pushonin, ‘se Ai, për të Cilin u parathanë’ tashmë ka ardhur. Por në porosinë morale nuk pati ndryshim nga Ligji i Vjetër; për më tepër, shumë prej tyre u zgjeruan

më tej nga mësimi i Ungjillit, që të ishin më të qarta dhe më të përsosura për të na mësuar shpëtimin, sesa atëherë kur na premtonin një Shpëtimtar⁴².

42 Toal, vol. 2, fq. 151



Hapi i dytë: Provoje besimin tënd

IKONA E KATËR UNGJILLORËVE



Kjo ikonë tregon hapin e dytë në procesin e shpëtimit: Duhet ta “Provojmë Besimin”. Ne e shfaqim besimin tonë se Krishti është Shpëtimtari ynë, duke u përpjekur të bëhemi si Ai, të drejtuar nga Jeta e Tij e shkruar tek Ungjijtë.

O Zot njeridashës, bëj që të shkëlqejë në zemrat tona drita e kulluar e njohjes së hyjnisë Sate, dhe çel sytë e mendjes sonë për të kuptuar mësimet e Tua ungjillore. Futna dhe frikën e porosive të Tua të lumtura, që, pasi të shtypim të gjitha dëshirat trupore, të mundim të kalojmë një jetë shpirtërore, duke menduar dhe duke bërë të gjitha ato që të pëlqejnë.

Se Ti je ndriçimi i shpirtave dhe i trupave tanë, o Krisht Perëndi, dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, bashkë me Atin Tënd pa fillim, dhe Shpirtin Tënd të tërëshenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

*Lutje para leximit të Ungjillit
Nga Liturgjia Hyjnore e Shën Joan Gojartit*

Sepse ka për të ardhur koha kur nuk do të durojnë mësimin e shëndoshë, por do të mbledhin grumbull pranë vetes së tyre mësuës sipas dëshirave të tyre, për të gudulisur veshët. Edhe nga e vërteta do t'i largojnë veshët, edhe do të kthehen pas përrallave. Po ti rri zgjuar në të gjitha, vuaj, bëj punë ungjillore, shërbesën tënde mbaroje.

(2 Timotheut 4:3-5)



Kapitulli i dytë

SEKRETI I SHPËTIMIT

Ndoshta çdonjëri nga ju do t'i thotë vetes: *Unë kam besuar, do të shpëtoj. Ai thotë të vërtetën, nëse besimit i bashkon vepra të mira. Në fakt ky është besimi i vërtetë, i cili nuk mohon me vepra ato që thotë me fjalë. Ja çfarë thotë shën Pavli në lidhje me këtë për disa besimtarë të rremë: Pohojnë me gojë se njohin Perëndi, po me vepra e mohojnë, sepse janë të ndyrë dhe të pabindur, edhe në çdo punë të mirë të paprovuar (Titit 1:16). Po kështu edhe shën Joani: Ai që thotë e kam njohur atë, edhe nuk ruan urdhërimet e tij, është gënjeshtar, edhe e vërteta nuk është në të (1 Joani 2:4).*

Shën Grigori i Madh

M. F. Toal, *Predikimet e të Dielave të Etërve të Mëdhenj*

SHPËTIMI ËSHTË PROCES

Teologjia orthodhokse mbron të vërtetën se shpëtimi është procesi i shenjtërimit: rritje personale drejt

ngjashmërisë me Perëndinë, duke ndjekur shembullin e Krishtit (theosis). Ky proces, që bëhet i mundur nga hiri, ushqehet nga besimi, vazhdon dhe në këtë jetë edhe përtej frymëmarrjes sonë të fundit mbi tokë. Ne shpëtojmë nga hiri, nëpërmjet besimit.

“Jisui, Dielli i Drejtësisë, u ngjall. Rrezet e këtij Dielli shpirtëror shpërndahen në të gjitha drejtimet; dhe në të vërtetë një merr më pak hir dhe një tjetër më shumë; jo sepse ky hir u jepet vetë në këtë masë, por është predispozicioni ynë që furnizon masën. Për ne, dielli është ai që i jep dritë gjithë universit, edhe rrezja dhe shkëlqimi i tij është një, dhe sërish ai nuk ndriçon me të njëjtën dritë mbi të gjithë botën. Diku ka shkëlqim të mrekullueshëm, diku tjetër më pak. Një shtëpi ka pak dritë dielli, një tjetër ka me bollëk; jo sepse dielli i jep më shumë dritë kësaj shtëpie dhe më pak tjetrës, por sipas pozicionit të dritareve të cilat janë të hapura ndaj tij prej atyre që ndërtuan shtëpitë, njëra shtëpi ka më shumë hapësirë për të hyrë dielli dhe ai futet sipas hapësirës. Dhe, meqenëse mendimet dhe synimet tona janë dritaret e shpirtit tonë, kur e hapni gjerësisht zemrën tuaj, merrni më shumë dhe më bujarisht hir

hyjnor. Ndërsa kur e ngushtoni shpirtin tuaj,
merrni më pak bujarisht hir. Hapjani dhe
dorëzohani zemrën e shpirtin tuaj Perëndisë,
që shkëlqimi i Tij të hyjë te ju.”
(Shën Joan Gojarti⁴³)

Procesi i shpëtimit është sinergjik, përpjekje bashkë-
punuese midis njeriut dhe Perëndisë, “I cili është
njëkohësisht e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja”⁴⁴. Si
të krishterë orthodhoksë themi:

U SHPËTOVA (Hebrenjve 10:10),
kur Jisu Krishti vdiq në Kryq për të më
çliruar nga mëkatet e mia. Ai e bëri të mu-
ndur shpëtimin tim. Para se Ai të bënte këtë,
rruga e vetme për në qiell ishte nëpërmjet
zbatimit të përpiktë të Ligjit⁴⁵, një akt i
pamundur.

Ngaqë Zoti ynë “pagoi” dënimin me vdekje
për mëkatet tona, në kuptimin literal kjo nuk
mund të merret si çmim që u dha për page-
sën e dikujt, por si Shpëtimtar që pranon

43 Toal: “Për Ungjillin”, vol. 1, fq. 417

44 George Cronk: *Mesazhi i Biblës, Perspektivë e Krishterë
Orthodhokse*, fq. 265

45 Romakëve 4:13-15, 7-8:4

pasojat e dhimbshme për veprimet e gabuara të të tjerëve. Kur mori trup njerëzor, Biri i Perëndisë ia nënshtroi veten vdekjes, e cila i erdhi njeriut si rezultat i mëkatit. Por Krishti ishte i pamëkatshëm, kështu që vdekja nuk mund ta mbante dot. Në të njëjtën mënyrë, sipas termave të Besëlidhjes së Gjakut, vdekja nuk mund të mbajë askënd që është i lidhur me Krishtin nëpërmjet Pagëzimit dhe Eukaristisë si pjesë e jetës në besim.

JAM I SHPËTUAR (Mattheu 13:35; Efesianëve 3:8-12), sepse E DI SEKRETIN, që rruga për në Mbretëri është nëpërmjet Jisu Krishtit, Birit të Perëndisë, Shpëtimtarit të të gjithë atyre që kthehen tek Ai⁴⁶. Gjithsesi, nëse, për shembull, unë do të studioja matematikë, nuk do të më lejohej thjesht ta informoja mësuesin që i dija parimet e asaj shkence dhe kështu të *merrja* një notë kaluese! Unë duhej të jepja provim. Në të njëjtën mënyrë, besimi që shpallim, nuk është besim i vërtetë, nëse nuk tregohet me vepra nëpërmjet mënyrës së të jetuarit. Kështu që, në përmbushjen e së vërtetës, vazhdojmë të themi....

46 Joani 14:6

JAM DUKE U SHPËTUAR (Hebrenjve 10:14) – sepse e tregoj besimin tim te Krishti si Mesia, në mënyrën e themeluar nga Perëndia: *duke u përpjekur të bëhem si Ai nëpërmjet bindjes (THEOSIS), sa më shumë të jetë e mundur*. Jeta e përsosur e Zotit tonë është shembulli që duhet të ndjekim⁴⁷. Ky është proces. Ashtu si shën Pavli shkroi: “Ne të gjithë duhet të rendim drejt përsosmërisë”⁴⁸. “Po bëhemi gjithnjë e më shumë ajo që tashmë jemi potencialisht me anë të Besimit dhe Pagëzimit”⁴⁹, pjesë e Trupit të Krishtit. Kjo aftësi na jepet si shenjë nga Perëndia, e cila është e dukshme në prirjen e fëmijëve për të veshur karakteristikat e heronjve të tyre. Kjo shtysë e brendshme duhet të shfrytëzohet dhe të drejtohet te një përpjekje e zellshme për të veshur cilësitë e Shpëtimtarit tonë, të tregojmë dashurinë dhe besimin tonë ndaj Tij dhe të përgatitemi për jetën në Mbretërinë e Tij, ku gjithçka është e shenjtë⁵⁰. Kjo lloj jete është e mbushur me “veprat e mira” të Besëlidhjes

47 1 Pjetri 2:21

48 Filipianëve 3:12-16

49 Papadopoulos, fq. 56

50 Hebrenjve 12:14

së Re, të cilat janë shumë të ndryshme nga veprat ligjore të Ligjit të Moisiut. Ato asnjëherë nuk mund të na çojnë në qiell, por janë tregues të besimit. Ato janë edhe mjetet me anë të të cilave Perëndia dëshiron të bëhet puna e Tij me njerëzit e Tij si duart, këmbët, sytë dhe zemra e Tij⁵¹. Nëse veprat nuk bëhen si rezultat i besimit, ato nuk kanë vlerë shpirtërore⁵², sepse ato sjellin vetëm përfitime të përkohshme. Veprat e bëra në emër të Jisu Krishtit dhe si fryt i besimit tek Ai, sjellin shumë më tepër përfitime nga ato që duken. Bërësi është i bekuar me hir, i cili e forcon atë sipas përpjekjes së tij dhe e ndihmon të vazhdojë veprat që dëshmojnë besimin e tij. Marrësi i përfitimit të veprave të mira të bëra në emër të Krishtit, merr atë që është edhe më e rëndësishmja, një shije të dashurisë që e pret në Mbretëri, nëse edhe ai beson. “E mira” vjen duke treguar Udhën për në Mbretëri.

DO TË SHPËTOHEM (Rom. 10:9), kur jeta ime, periudha ime e provës, të mbarojë ose në Ardhjen e Dytë të Krishtit, cilado që të

51 1 Korinthianëve 12:27

52 Hebrejve 11:6

ndodhë më parë. Shembulli i Enokut dhe i Ilias që u morën direkt në Qiell janë parafigurime të atyre që ende do të jenë gjallë në Ardhjen e Dytë, të cilët, ngaqë i përkasin Atij, nuk do të kalojnë nga vdekja⁵³. Në fakt, duhet të përballem me Gjykimin⁵⁴, sepse vetëm Perëndia (nëpërmjet Birit të Tij mbi Fronin e Lavdisë së Tij) mund ta dijë nëse kisha me të vërtetë besim dhe dashuri për Krishtin. Jeta ime nuk do të vlerësohet nga sukseset apo dështimet, por nëse u përpoqa në të vërtetë ose jo për të jetuar jetën sipas shembullit të Krishtit, si pasojë e besimit. Për të treguar dashurinë e tyre për Perëndinë, Adami dhe Eva duhej t'i bindeshin urdhrit të vetëm që Ai u dha. Për të treguar dashurinë dhe besimin tonë ndaj Jisu Krishtit si Shpëtimtar, duhet të përpiqemi të ndjekim shembullin e Tij në çdo gjë, si njohjen e ekzistencës së Tij, ashtu dhe pranimin e Tij si Zoti dhe Mjeshtri ynë. Zbulesa 20:12-13 thekson qartë se besimi ynë gjykohet nga veprat tona.

*Jeta do të kalojë shumë shpejt;
ajo çka bëhet për Perëndinë, do të mbetet gjithmonë!*

53 1 Thesalonikasve 4:15-18

54 Joani 5:26-30

Çfarë roli luan hiri i Perëndisë në shpëtimin tonë?⁵⁵
Hiri është ndihma e mbinatyrshme që i jepet njeriut për ta shenjtëruar atë për në Mbretëri. Ai mundëson vepra të mira ose përpjekje për t'i bërë ato⁵⁶. Pa hir, nuk do të ishte e mundur rritja në ngjashmërinë e Krishtit.

“Hiri i Perëndisë nuk mund t'i vizitojë ata që i largohen shpëtimit. As virtyti njerëzor nuk ka pushtet të tillë, që t'i lartësojë në jetën autentike ata shpirta që nuk janë prekur nga hiri... Por kur drejtësia e veprave dhe hiri i Shpirtit vijnë së bashku në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin shpirt, së bashku ata mund ta mbushin atë me jetë të bekuar.” (Shën Grigori i Nisës⁵⁷)

Në kohën e gjykimit, hiri do të plotësojë edhe dobësitë e atyre që jetuan me besim. Perëndia na thërret të jemi të përsosur në imitimin e Zotit, që të dëshmojmë besimin tonë dhe të rritemi duke i ngjarë Atij. Megjithatë, Ai kërkon që vazhdimisht të përpiqemi të bëjmë më të mirën që mundemi, hiri i Tij plot mëshirë plotëson

55 Efesianëve 2:8-10

56 Arkimadrit Kristofori Stavropulos: *Pjesëmarrës të Natyrës Hyjnore*, përkth. Atë Dr. Stanley S. Harakas, fq. 35

57 Ibid, fq. 34

mungesat⁵⁸. Prandaj lutemi gjatë gjithë kohës: Mëshiro, o Zot. Hiri na drejtëson, dhe për më tepër na shenjtëron⁵⁹.

Roli i Krishtit në shpëtimin tonë është objektiv. Ai bëri të mundur edhe një herë bashkimin e njeriut me Perëndinë. Roli ynë është subjektiv. *Njeriu i brendshëm*, për të cilin shën Pavli shkroi⁶⁰, e njeh Krishtin si Mesia dhe e shfaq besimin në një nivel mistik nëpërmjet lutjes, Pagëzimit, Vajosjes, Eukaristisë dhe Mistereve të tjera të Kishës. *Njeriu i jashtëm* e shfaq këtë besim në një nivel moral duke treguar dashuri ndaj të tjerëve në një marrëdhënie të drejtë me Perëndinë, duke ndjekur shembullin e Krishtit.

Shpëtimi ynë do të bëhet realitet, “do të aktualizohet”, kur të përfundojmë jetën në tokë. Shpirtrat tanë do të gjykojnë menjëherë dhe pastaj, të shkëputur nga trupi, do të parashijojmë atë për të cilën jemi përgatitur. Nëse besimi te Zoti është shfaqur duke qenë në unitet me Të, nëpërmjet bindjes, atëherë do të përjetojmë gëzimin e pranisë së Tij. Pastaj, në Ardhjen e Dytë të Krishtit, do të ngjallemi me trup të ri dhe do të hyjmë në plotësinë e Mbretërisë.

Nëse ju kërkohet përgjigja e saktë e pyetjes “A je i shpëtuar?”, përgjigja më e përshtatshme dhe më e

58 Titos 3:4-7

59 Romakëve 3:23-26; 2 Thesalonikasve 2:13-17

60 1 Korinthianëve 2:11

përmbledhur do të ishte: “Po, sipas hirit të Perëndisë, jam duke u shpëtuar, (duke u rritur në shenjtërim me anë të përpjekjeve për të jetuar në bindje ndaj Krishtit, që të tregoj besimin dhe dashurinë time⁶¹). Por duhet të përpiqemi t’i kuptojmë plotësisht të gjitha stadet që përfshihen në procesin e shpëtimit dhe të jemi të gatshëm e të etur për t’u treguar edhe të tjerëve për këtë njohuri jetëdhënëse. Duke vepruar kështu, mishërojmë llojin e dashurisë që Jisui praktikoi dhe mësoi⁶².

RREZIKU QË MBART TEORIA E “SHPËTIMIT TË MENJËHERSHËM”

Janë disa që pretendojnë teorinë e ashtuquajtur “shpëtim i menjëhershëm”, e cila është në kundërshtim me mësimet e Kishës së Hershme, si rrjedhim edhe me Teologjinë Orthodhokse. Ata citojnë Romakët 10:9 si referencën e tyre biblike: *Sepse, po të rrëfesh me gojën tënde Zotin Jisu, dhe po të besosh në zemrën tënde se Perëndia e ngjalli prej së vdekurish, do të shpëtosh*. Nuk ka nevojë për diskutim, se rruga e vetme për shpëtim është ajo nëpërmjet besimit te Jisu Krishti si Shpëtimtar. Megjithatë, Orthodhoksia nuk pajtohet me ata që

61 Hebrenjve 5:8-9

62 Joani 15:9-17

mendojnë se shpëtimi është një ngjarje e menjëhershme: mjafton që dikush ta shpallë me zë Jisuin si Zot dhe të thotë: “Jam i shpëtuar”! Zakonisht, ata që shpallin këtë deklaratë, paraqiten me një lloj zelli i cili është dhe i admirueshëm, dhe kërcënues. Është i admirueshëm, sepse shfaqet besimi prej fëmije, me forcën e bindjes që shfaq Pjetri kur pohoi se Jisui është Biri i Perëndisë së gjallë⁶³. Është kërcënues, sepse ata që ekspozohen ndaj këtij deklarimi ose do të largohen nga thjeshtësia e tij, ose do të ofendohen nga agresiviteti me të cilin shfaqet: *Sepse dëshmoj për ta se kanë zell për Perëndinë, po jo me vetëdije* (Romakëve 10:2).

Thjeshtëzimi që bart teoria e shpëtimit të menjëhershëm i vjen në ndihmë atyre që lënë jashtë vëmendjes procesin e vazhdueshëm të shenjtërimit, ngaqë kjo teori përkrah bindjen e atyre që duan ta konsiderojnë veten të krishterë, por nuk duan të përpiqen për të jetuar një jetë ashtu si mësoi Jisui. Kështu mund të ndihen të lirë të ndjekin mënyrat e botës, ndërsa po presin pa hezitim të shkojnë në Qiell kur të vdesin, të bindur se, meqenëse Krishti vdiq për mëkatarët, nuk ka nevojë për ta të “bëjnë” gjë tjetër, veçse atë që i kënaq. Nga ana tjetër, agresiviteti i atij që shpall shpëtimin e menjëhershëm, që këmbëngul në faktin se çdonjëri duhet të besojë ashtu si ai mendon, mund t’i bëjë të tjerët të mbrohen dhe ta

63 Matheu 16:13-18

mbyllin me kaq këtë çështje. Në secilin rast, Satanai e ka përmbushur qëllimin e tij: të vonojë ose të pengojë rritjen shpirtërore. Deklarimi i pabazë : “Jam i shpëtuar!” na sjell ndër mend qëndrimin e Fariseut, zëri i të cilit jehoi në lavdërimin e vetes, në mungesën e përulësisë dhe në arrogancën që Krishti e dënoi. Qëndrimi pendues i taksambledhësit që rrihte kraharorin e tij dhe murmuriste: “Perëndi, ki mëshirë për mua mëkatarin”, mori miratimin nga Jisui, i Cili tha: “Sepse kushdo që ngre lart veten e tij, do të përulet; dhe ai që përul veten e tij, do të ngrihet lart” (Lluka 18: 9-14).

Shkrimi mund të kuptohet saktë vetëm në tërësinë e tij, jo duke shkëputur fragmente jashtë kontekstit. Të ngulësh këmbë në një interpretim literal të një fjalie të shkëputur aty-këtu nga teksti, do të thotë të mbështetesh te germat e të injorosh shpirtin⁶⁴, gjë që e çoi shumicën e kombit hebre në mohimin e Krishtit si Mesian e tyre. Për të kuptuar plotësisht Romakët 10:9, duhet të kujtojmë se shën Pavli u drejtohej Judenjve të Romës duke u përpjekur t’i ndihmonte të kuptonin se për shpëtimin nuk ishin më të varur nga Ligji i Moisiut. Ligji u zëvendësua nga Besëlidhja e Gjakut, ku kriteri i vetëm është besimi te Jisu Krishti si Shpëtimtar. Megjithatë, shën Pavli e thotë qartë te Romakët 3:31: *Ligjin, pra, hedhim poshtë me anë të besimit? Qoftë larg; por ligjin*

64 2 Korinthianëve 3:6.

vërtetojmë. Ligji nuk është shfuqizuar nga ardhja e Krishtit, por u përmbush prej saj, siç na e thotë qartë Jisui te Mattheu 5:17.

TË RRITEMI NË NGJASHMËRINË E KRISHTIT

Mesazhi i Letrës drejtuar Romakëve, nëse merret në plotësinë e tij, thotë se, nëse vërtet besojmë se Krishti është Shpëtimtari ynë, do të mësojmë se besimi dëshmohet duke u përpjekur të jetojmë duke e imituar Atë, dhe kështu do të shpëtojmë. Imitim i Krishtit do të thotë të duam njëri-tjetrin ashtu si Ai na deshi, kjo është edhe përmbledhja e Dhjetë Urdhërimeve dhe e Ligjit⁶⁵. Që do të thotë të japim jetën tonë për të tjerët, ashtu si Ai e dha veten Tij për ne. Kjo kërkon përpjekje, madje shën Pavli na nxit edhe *të durojmë vuajtje* si ushtarë të mirë dhe *të ecim sipas rregullave* si atletët (2 Timotheut 2:3-5); *të veshim gjithë armët e Perëndisë, që të mund t'u qëndrojmë kundër mjeshtërive të djallit* (Efesianëve 6:11); dhe *të punojmë për shpëtimin e vetes sonë me frikë e me dridhje* (Filipianëve 2:12). Ai thekson se nëse duam Krishtin, *shpëtimi ynë është më afër sesa kur besuam* (Romakëve 13:11), që do të thotë se sa më shumë jetojmë “në Krishtin” (të bashkuar me Të nëpërmjet Pagëzimit, Eukaristisë dhe një jete besimi), më shumë i afrohem

65 Romakëve 13:8-10.

shpëtimit, i cili sigurohet vetëm kur jeta jonë në tokë mbaron dhe kur besimi ynë ta ketë kaluar provën. Për aq kohë sa jemi ende në jetë, mund të ndodhë që të largohemi nga udha e Perëndisë, por Ai që *duron deri në fund, do të shpëtojë* (Marku 13:13), dhe do të marrë *kurorën e jetës* nga vetë Krishti (Zbulesa 2:10).

Teoria e shpëtimit të menjëhershëm njihet formalisht si “shfajësim vetëm nga besimi”⁶⁶. Orthodhoksia kalon nga shfajësimi te shenjtërimi *nëpërmjet besimit*, dhe mohon fjalën “vetëm”, e cila mbart në vetvete konceptin që nuk nevojiten vepra apo punë të mira, si shfaqje ose provë e besimit. Martin Luteri, një ish-prift romano-katolik, theksoi shfajësimin vetëm nga besimi, për arsye të shqetësimit të tij të thellë rreth theksimit të tepërt të veprave, dhe ishte futur në teologjinë e Kishës Romane (duke kulmuar në shekullin e 16-të me shitjen e indulgjencave, që dha përshtypjen se shpëtimi mund të blihet). Shqetësimet e Luterit ishin të justifikuara dhe synimi i tij ishte i mirë, por teologjia e tij (e cila shënoi fillimin e Reformimit Protestant) krijoi një thyerje në lidhjen vendimtare midis besimit të shpallur dhe elementeve esenciale të një jete sipas shembullit të Krishtit (Jakovi 2:14-26).

66 Mendohet që kjo teori nisi nga koha e Reformimit Protestant me Martin Luterin, por në fakt kjo ka qenë një nga herezitë e shekullit të parë. Pjesa më e madhe e letrës së Jakovit u shkrua si përgjigje ndaj kësaj herezie. Shiko Crong. fq. 233.

“Shfajësimi vetëm nga besimi” zakonisht përfshin një nga këto këndvështrime: 1) Pas shpalljes së besimit, veprat e mira vijnë në mënyrë të natyrshme, por *nuk* janë të domosdoshme për shpëtimin; 2) Pas shpalljes së besimit (i cili është dhuratë nga Perëndia), Shpirti i Shenjtë do të sjellë ndryshim në jetën e njeriut dhe rritje në ngjashmërinë me Krishtin⁶⁷. Këndvështrimi i parë është shumë i paqartë, i mungon sensi i vigjilencës që na mësoi Kisha e hershme. Për fat të keq, zakonisht ne nuk bëjmë atë që na kërkohet, pa u bindur për domosdoshmërinë e saj. I dyti e vendos të gjithë barrën mbi Perëndinë dhe asgjë mbi njeriun, dhe nuk merr parasysh vullnetin e lirë. Përkundrazi, Dhiata e Vjetër dhe ajo e Re, që nga Adami dhe Eva deri tek i verbri i lindur, shikimi i të cilit u kthye vetëm kur iu bind urdhrat të Zotit tonë për *shkuar për t’u larë te pusi i Siloamit* (Joani 9:7-11), vërteton faktin që Plani i Perëndisë për shpëtimin tonë, nëpërmjet besimit të Jisu Krishti si Mesia, ka fuqi, por kërkon që besimi të tregohet me vepra dhe të jetë çështje e gjykimit të Tij. Letra drejtuar Hebrenjve na jep shembuj të shumtë të besimit të shfaqur nga njerëz të Perëndisë, duke cituar shembuj kur ata nënshtruan *mbretëri, punuan në mënyrë të drejtë, mbajtën premtimet, ndaluan gojët e luanëve... dhe siguruan një dëshmi të mirë nëpërmjet*

67 J. Leslie Dunstan: “Protestantizmi”, fq. 208-210.

besimit... (Hebrenjve 11:32-39). Ata nuk thanë thjesht se besojnë, ata *e vërtetuan* besimin me mënyrën e tyre të jetuarit (nëpërmjet veprave të tyre).

MËNYRA PËR TË TREGUAR BESIMIN

Pjesa më e rëndësishme e punës sonë për Perëndinë dhe mënyra për të treguar besimin dhe dashurinë për Krishtin është që, si *fizikisht* dhe *shpirtërisht*, të ushqejmë të uriturin, t'i japim të pijë të eturit, të veshim të zhveshurin, t'i shërbejmë të sëmurit dhe të vizitojmë të burgosurin⁶⁸. Jisui vetë tha se sa herë që ndihmojmë njerëzit në nevojë, i shërbejmë Atij. Kjo nuk do të thotë thjesht të ndihmojmë me raste. Puna e Perëndisë duhet të bëhet mënyrë jetese, *Jetë në Krishtin*, e cila duhet të prekë të gjitha aspektet e programit tonë të përditshëm. Në mendjen tonë duhet të kemi gjithmonë pyetjen: "Çfarë do të bënte Jisui në këtë rast?" Pastaj duhet të përpiqemi të veprojmë sipas mësimit të Tij.

Ava Agathoni thotë se, nëse një i krishterë mban në mendje çdo moment gjykimin që

68 Mattheu 25:31-46

pason vdekjen, ai nuk do të mëkatojë aq lehtë⁶⁹.

Jisui tha se, nëse nuk jemi *me* Të, jemi *kundër* Tij⁷⁰, duke nënkuptuar se Mbretëria fitohet me punë. Indiferecë do të thotë mohim. Zbulesa 3:16 na paralajmëron se Perëndia do të na vjellë nga goja e Tij, nëse jemi të vakët, as të ftohtë dhe as të ngrohtë. Perëndia na jep jetë të bëjmë zgjedhjen tonë dhe ta shfaqim këtë zgjedhje në të gjitha veprat dhe vendimet tona.

Kapitulli i pestë i Romakëve përshkruan dhuratën falas që mund të jetë jona nëpërmjet besimit te Jisu Krishti, por kapitulli i gjashtë përshkruan *risinë* e jetës në të cilën duhet të ecim, drejt shenjtërisë dhe përjetësisë me Perëndinë (6:22). Ai na tregon se duhet të *bëhemi skllëvër të Perëndisë*. Kur themi se duhet të shfaqim ose të tregojmë besimin tonë te Krishti, nuk do të thotë që mohojmë faktin se shpëtimi është dhuratë nga Perëndia. Asnjë shumë parash nuk mund ta blejë atë, dhe ne asnjëherë nuk “bëjmë” mjaftueshëm për ta fituar atë; dhe në fakt shpëtimi nuk shitet. Në këtë mënyrë, nëse, as nuk e blejmë dot e as nuk e fitojmë, e kuptojmë qartë se shpëtimi është dhuratë për ata që e pranojnë. Në termat e Besëlidhjes me Gjak të Perëndisë, kjo dhuratë

69 Gojarti, fq. 94.

70 Mattheu 12:30.

e mrekullueshme u jepet atyre që jetojnë me besim te Krishti, se, kështu si jemi, nuk e meritojmë shpëtimin, sepse, që ta meritojmë, duhet të jemi të pamëkatë, ashtu siç ishte Krishti.

Veprat që janë tiparet e një jete të ngjashme me atë të Krishtit, jo vetëm që shfaqin besim, por edhe tregojnë rritje shpirtërore, e cila është e pamundur pa vepra. Jeta shpirtërore është kështu: jetë e cila funksionon në nivelin shpirtëror, nëpërmjet lutjes, meditimit për të vërtetat e Perëndisë, mësimi të fjalës së Tij, bërjes së vullnetit të Tij, ofrimit të kohës, talentit dhe thesarit tonë, cilitdo dhe kudo jemi. Ata që janë pjesë e kësaj jete të besimit, rriten vazhdimisht në ngjashmërinë e Perëndisë dhe zhvillojnë me Të marrëdhënie të pasur gëzimi, e cila fillon në këtë jetë dhe do të vazhdojë të rritet përjetësisht. Kjo marrëdhënie do të reflektohet në një emër që Ai do të shkruajë mbi një gur të bardhë, që do t'i japë secilit prej atyre që e deshën Atë, ndërsa hyjnë në plotësinë e Mbretërisë së Tij⁷¹. Në atë vend të bekuar nuk do të ketë as zili, as konkurrencë, sepse cilësitë e veçanta të çdo marrëdhënieje do të jenë personale, vetëm Perëndia i di⁷².

71 Zbulesa 2:17.

72 Ware, fq. 183-185.

Shën Grigori i Madh

NGJARJA QË HAPI DYERT E PARAJSËS

... sado që para ardhjes së Zotit Etërit jetuan me drejtësi, nuk hynë në Mbretëri derisa Krishti hapi dyert e Parajsës me anë të vdekjes së Tij. Ata ankoheshin sepse kishin jetuar me drejtësi për të fituar Mbretërinë, por iu desh të prisnin gjatë për të hyrë në të. Ata punuan në Vresht, por banesat e hadhit, madje paqësore, i morën pavarësisht nga jeta e tyre e drejtë. Vetëm pas një periudhe kohe shumë të gjatë ata arritën gëzimin e Mbretërisë. Megjithatë, ne që kemi ardhur në orën e njëmbëdhjetë, le të mos ankohemi për punën tonë. Ngaqë erdhëm në këtë botë pas Ardhjes së Ndërmjetuesit, ne hyjmë në Mbretëri pothuajse sapo lëmë trupin tonë, dhe marrim pa vonesë atë që Etërit e vjetër u bënë të denjëta mernin pas një pritjeje të gjatë⁷³.

Shën Joan Gojarti

PËR GJYKIMIN

T'i kemi parasysh të gjitha këto dhe t'i besojmë në zemrën tonë, se, pas jetës së tanishme, do të qëndrojmë

73 Toal, vol. 1, fq. 382.

përpara gjykatores së frikshme, do të japim llogari për të gjitha ato që kemi bërë. Atje do të merret vendim dhe do të vuajmë ndëshkimin, nëse qëndrojmë në mëkatet tona ose do të marrim kurorën dhe gjëra të tjera të mira të panumërta, nëse në këtë jetë të tanishme të shkurtër kujdesemi për shpirtin tonë. Le t'ua mbyllim gojën atyre që guxojnë të thonë e të shpallin atë që është në kundërshtim me këtë besim. Le të ecim në udhën e virtytit, kështu, duke iu afruar me zemër plot besim asaj gjykatores, të marrim gjërat e mira që Ai na premtoi, nëpërmjet hirit dhe mëshirës së Zotit tonë Jisu Krisht, të Cilit i përket nderi dhe lavdia tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin⁷⁴.

74 Ibid, vol. 2, fq. 25



Hapi i tretë: Përballemi me Gjykimin
IKONA E KRISHTIT PANTOKRATOR



*Mozaik, Katedralja
“Ngjallja e Krishtit”, Tiranë*

Krishti, Pantokrator, Sundimtari i të Gjithave, i Cili do të gjykojë të gjallët dhe të vdekurit nëpërmjet së vërtetës që gjendet në Ungjij (Rom. 2:16). **Kjo ikonë thekson hapin e tretë të procesit të shpëtimit: Të gjithë do të “Përballemi me Gjykimin”.**

Kur Agathoni i Shenjtë ishte në prag të vdekjes, qëndroi tri ditë pa lëvizur në shtrat, sytë i mbante hapur dhe të drejtuar nga qielli. Në ditën e tretë, kur u përmirësua disi, nxënësit e tij që ishin mbledhur përreth, e pyetën që t'u tregonte se ku ishte shpirti i tij përgjatë këtij intervali kohe.

Para Gjykatores së Perëndisë, - murmuriti ai duke u dridhur.

A je i frikësuar atë? - e pyetën nxënësit me ngurrim.

Gjatë gjithë jetës sime, u përpoqa sa munda që të ruaja sa më mirë ligjet e Perëndisë, por njeri jam. Si ta di që e kam kënaqur Perëndinë? - u përgjigj shenjtë me shumë dhimbje.

“Nuk je i sigurt se veprat e tua e kënaqën Perëndinë”?! - e pyeti një nxënës me habi.

Derisa të jem para Perëndisë, jo, nuk jam i sigurt, - u përgjigj shenjtë, - sepse njeriu gjykon me standard të ndryshëm nga ai i Perëndisë.

Nxënësit donin ta pyesnin për gjëra të tjera për përfitimin e shpirtit të tyre, por shenjtë u bëri shenjë të mos i flisnin më tepër.

Jam i shqetësuar, - pëshpëriti ai.

Fytyra e tij filloi të ndriçonte! Nxënësit e panë teksa largohej nga kjo botë e kotë dhe po shkonte në jetën e përjetshme me gëzimin që ndien dikush kur takon personin e tij më të dashur.

Arkimandrit Krisostomi
Etërit e Hershëm të Shkretëtirës



Kapitulli i tretë

UDHA PËR NË MBRETËRI

Singklitikia e bekuar u thotë motrave se ata që e fillojnë jetën në Perëndinë hasin shumë mundime e pengesa në fillim, megjithatë, më pas, gjejnë gëzim të papërshkrueshëm.

Sepse, sikundër ata që kanë dëshirë të ndezin një zjarr, fillimisht u merret fryma dhe u lotojnë sytë nga tymi, por më vonë kanë sukses në punën e tyre, kështu edhe ne që dëshirojmë të ndezim zjarrin hyjnor brenda vetes duhet ta dimë se do të kemi sukses në të, vetëm pas një lufte dhe pune të gjatë; sepse edhe Zoti thotë: “Erdha të vë zjarr mbi dhé; edhe ç’dua më, në qoftë se tani u ndez?”

Por në fakt disa, ngaqë nuk durojnë dot tymin dhe shqetësimin që ai shkakton në fillim kur ndizet zjarri, kjo do vetëm pak përpjekje, nga përtacia nuk e ndezin fare, largohen shpejt dhe nuk kanë vetëpërmbytje për të vazhduar deri në fund.

Arkimandrit Krisostomi
Etërit e Hershëm të Shkretëtirës

NUK ËSHTË E LEHTË

Udhë për në Mbretërinë e Perëndisë është shpesh me gropë dhe disa herë e rrezikshme⁷⁵, por ajo të çon te *margaritari i çmuar* (Mattheu 13:46). Asnjë përpjekje nuk është aq e madhe për një thesar kaq të lavdishëm. Roli ynë në procesin e shpëtimit përbëhet nga katër hapa:

1. BESOJ - Pranoj se Jisu Krishti është Biri i Perëndisë, Shpëtimtari ynë, i Cili na siguron Udhën e vetme për në praninë e përjetshme të Krijuesit tonë⁷⁶, ashtu si e shpallim çdo herë që themi Besoren e Nikesë.

Besoj... në një Zot, Jisu Krishtin, Birin e Perëndisë, të vetëmlindurin, që lindi prej Atit përpara gjithë shekujve... Që për ne njerëzit dhe për *shpëtimin tonë* zbriti prej qiejve dhe u trupëzua prej Shpirtit të Shenjtë edhe Virgjëreshës Mari, dhe u bë njeri.

Te kjo njohje mund të arrijmë në çdo kohë. Për aq kohë sa jetojmë, asnjëherë nuk është vonë të kthehemi në besim, nëse ai është i sinkertë⁷⁷. Por asnjëherë nuk e dimë se kur do të mbarojë jeta jonë. Vdekja nuk na lajmë-

⁷⁵ Mattheu 11:12.

⁷⁶ Joani 14:6; 1 Timotheut 2:4-5.

⁷⁷ Mattheu 20:1-16.

ron gjithmonë para se të vijë, kështu që, sa më shpejt t'i drejtohem çështjes së besimit, aq më mirë është⁷⁸. Sepse sa më shumë vonohemi, aq më shumë mund të largohemi nga Perëndia, dhe ndoshta as nuk do ta kuptojmë nevojën për Të, ose as nuk do ta dimë se si ta "gjejmë Atë" (Veprat 17:27).

2. PROVOJ BESIMIN - Përpykja për të ndjekur shembullin e Jisuit në të gjitha gjërat përgjatë gjithë jetës. Misteret e Shenjta të Kishës sigurojnë bazat e kësaj jete në Krishtin. Ato janë mjete të hirit të Perëndisë, që na ndihmojnë të forcohemi në luftë dhe të arrijmë qëllimin tonë.

Pagëzimi na bën pjesë të Trupit të Krishtit, Kishës⁷⁹. Fjala *i shenjtë* do të thotë *i veçuar për Perëndinë*. Pagëzimi na veçon, sepse i përkasim Atij, nëse përpiqemi të jetojmë sipas Tij⁸⁰. Ashtu si lindja fizike nga barku i nënës sonë na solli në botë, lindja jonë shpirtërore nëpërmjet Pagëzimit na vendos në udhën për në Mbretëri. Gjatë një momenti të këtij Misteri prifti fryn mbi ujin e Vaskës së Pagëzimit, frymën e një jete të re në Krishtin, e cila bëhet e mundur nëpërmjet këtij Misteri.

78 Marku 9:36-37, 10:13-16.

79 1 Korinthianëve 12:13.

80 Kolosianëve 1:18-23.

Jisui kërkon të lindim në një jetë të ndryshme nga ajo e gjithë kafshëve dhe e qenieve të tjera të gjalla, një jetë që është Jeta e Vetë Zotit. Kjo jetë është dhënë nga fryma e Perëndisë, që është Shpirti i Shenjtë i Perëndisë (*Pneuma*, në greqisht do të thotë edhe “frymë”, edhe “shpirt”). Perëndia tashmë na e kishte dhënë këtë frymë në Krijim (Gjeneza 2:7), pra, duke na dhënë ikonën e Tij, lirinë e Tij dhe mundësinë për t’u bërë gjithmonë e më shumë si Ai, nëpërmjet punës sonë krijuese. Për arsye të kësaj fryme, njeriu thirret gjithmonë ta tejkalojë veten, kështu ai është njeri i vërtetë, vetëm kur merr pjesë në natyrën e Perëndisë. Njeriu e humbi këtë frymë, këtë prani hyjnore, për shkak të mëkatit dhe vdekjes; por ai mund ta rifitojë atë në ujin e Pagëzimit, burimin e Jetës.

Atje në ujin e Pagëzimit, mëkati, i cili është shkaktari i vdekjes, zhytet si në ujërat e Përmbytjes ose të Detit të Kuq. Atje lulëzon Jeta e vërtetë, një Jetë e përjetshme në të cilën jeton Perëndia, Jetë e transmetuar nga Shpirti i Shenjtë jetëdhënës. Kjo është Jeta, të cilën erdhi të na e jepte Biri i Perëndisë, duke dhënë Shpirtin e Tij tek Ati mbi Kryq dhe pastaj duke u ngjallur prej së vdekurish, që

t' u dhurojë të njëjtin Shpirt atyre që i besojnë Atij⁸¹.

Pagëzimi është fillimi i udhëtimit tonë të krishterë, ashtu si ishte edhe fillimi i shërbesës publike të Jisuit. Nëpërmjet këtij Misteri, na jepet mundësia të çlirohemi nga pasojat e mëkatit të Adamit dhe të Evës dhe të pastrohemi nga çdo mëkat personal që mund të kemi kryer. Na jepet një mundësi e re, mundësia jonë personale për shpëtim. Megjithatë, edhe pse Pagëzimi është i fuqishëm dhe i domosdoshëm⁸², ai është vetëm fillimi, aty nisim.

Nëse pagëzohemi me dëshirë dhe dashuri pas moshës kur arsyetojmë, ky është një tregues i besimit tonë te Krishti. Sipas shën Pavlit, rrethprerja nuk u jepte automatikisht drejtësi judenjve që ishin nën Ligj. Për më tepër, ajo ishte një shenjë e jashtme, me meritën e vetme kur kushtet e brendshme të zemrës përshtateshin me kuptimin e saj: përkushtimin për të mbajtur besëlidhjen e Perëndisë me Moisiun ndërsa prisnin Mesian⁸³. Në të njëjtën mënyrë, Pagëzimi për të krishterët nuk është veprim magjik që garanton një vend në Qiell. Ai është shenjë e jashtme e hirit të brendshëm që kemi

81 Olga Dunlop: *Perëndia Jetëdhënës*, vol. 1, fq. 223.

82 Mattheu 3:13-15, 28:18-20; Joani 2:20.

83 Romakëve 2:25-29, 4:11-12.

marrë, fillim i procesit të shenjtërimit për ata që, pas kësaj, përpiqen të bëhen gjithnjë edhe më tepër si Krishti, aq sa munden; pasojë e natyrshme e besimit të vërtetë, por vetëm me shumë disiplinë dhe përpjekje.

Pagëzimi, Mirosja, Eukaristia dhe Efqelia janë transmetues shumë të rëndësishëm të hirit. Këto Mistere, në Kishën Orthodhokse, nuk u mohohen foshnjave. Nëpërmjet këtyre Mistereve, ndërsa rriten, ato marrin ushqim të gjallë shpirtëror për shpirtin e tyre, pikërisht ashtu si marrim ushqim për trupin para se të kuptojnë nevojën për vitamina dhe minerale. Nëse jemi pagëzuar kur ishim foshnjë, ky është një tregues i besimit të prindërve ose të nunëve tanë, të cilët që atëherë kishin përgjegjësinë të na ushqenin shpirtërisht ndërsa po rriteshim. Në një ambient të dashur dhe të mbushur me besim, kush mund të thotë me saktësi se kur fillon besimi dhe kush mund të kufizojë fuqinë e hirit? Duke u rritur, përgjegjësia për rritjen shpirtërore bëhet jona. Të jemi të sigurt se Pagëzimi ynë ka kuptim për ne. Është e rëndësishme të kuptojmë domethënien dhe fuqinë e tij; të kujtojmë datën e Pagëzimit tonë dhe të marrim Kungimin e Shenjtë në çdo përvjetor të Pagëzimit; të mbajmë një kryq në qafë si dëshmi të përkushtimit tonë ndaj Krishtit (jo si një stoli); të ripërtërijmë vazhdimisht përkushtimin tonë, veçanërisht gjatë Liturgjisë Hyjnore, e cila na jep shumë herë atë mundësi duke na kujtuar t'ia "përkushtojmë veten tonë dhe njëri-tjetrin, dhe

gjithë jetën tonë Krishtit, Perëndisë tonë”, le t’ia parashetrojmë dhe për më tepër ta jetojmë këtë përkushtim.

Mirosja na jep “vulën e dhuratës së Shpirtit të Shenjtë”,⁸⁴ elementin e dytë të lindjes shpirtërore, i nevojshëm për të hyrë në Mbretëri, ashtu si Krishti i tha Nikodemit⁸⁵. Vula është shenjë e autenticitetit. Ai që mban një vulë të posaçme, përcjell autoritetin e asaj që përfaqëson, ashtu si një dokument i shënuar me një vulë të një kombi të veçantë që mbart fuqinë e atij subjekti. Nëpërmjet Misterit të Mirosjes marrim Shpirtin e Shenjtë brenda nesh. Vula e kësaj dhurate vendoset mbi ne dhe vepron me fuqi sa herë veprojmë në përputhje me të. Sa më shumë bëhemi të ngjashëm me Krishtin në bashkëpunim me Shpirtin e Shenjtë, ndërsa Ai bekon përpjekjen tonë shpirtërore duke na forcuar, inkurajuar dhe drejtuar, kur përpiqemi përgjatë rrugës së pjerrët dhe të ngushtë për në Mbretëri, aq më tepër veprojmë me autoritetin e Perëndisë. Njerëzit që jetojnë në kungim me Të, e njohin këtë autoritet shpirtëror.

Eukaristia (Kungimi i Shenjtë) na jep mundësinë të marrim pjesë në Trupin dhe Gjakun e vërtetë të Krishtit, që është një ripërtëritje e vazhdueshme e bashkimit tonë

84 Miroja e shenjtëruar që përdoret në Misterin e Krezmimit mbart “vulën”, 2 Korinthianëve 1:21-22; 1 Joani 2:20.

85 Joani 3:5.

me Të dhe sigurim i fuqisë⁸⁶. Nëpërmjet këtij Misteri na jepet sërish mundësia për te Pema e Jetës, ushqimi i pavdekësisë, si pjesë e jetës në Krishtin.

“Ky gjak bën që imazhi i Mbretit tonë të jetë i gjallë brenda nesh; Ai prodhon bukuri të pashprehur, ruan fisnikërinë e shpirtit tonë prej humbjes, duke e ujitur dhe ushqyer atë vazhdimisht... Ky Gjak, **nëse merret në mënyrë të drejtë**, dëbon djajtë dhe i mban larg nesh, ndërkohë që na ofron Engjëjt dhe Zotin e Engjëjve. Sepse djajtë zhduken sa herë që shohin Gjakun e Zotit, dhe Engjëjt mblidhen së bashku... Ky Gjak është shpëtimi i shpirtit tonë. Prej Tij pastrohet, zbukurohet dhe ndriçohet shpirti. Kjo bën që të kuptuarit tonë të jetë më i ndritshëm se zjarri dhe shpirti ynë më rrezatues se ari; ky Gjak që u derdh, e bëri të arritshëm qiellin.”

Shën Joan Gojarti⁸⁷

Efqelia (Vajosja me vaj të shenjtë) është një mjet për shërim trupor dhe shpirtëror. Ashtu siç thuhet edhe te

86 Mattheu 26:26-28; Llukai 22:19-20; Joani 6:56.

87 Philip Schaff: “Fjalimi XLVI i Ungjillit sipas Joanit”, Etërit nikeas dhe post nikeas të Kishës së Krishterë, vol. XIV, fq. 166-167.

Letra e Jakovit, ne mund të pyesim priftin për lyerjen dhe lutjet për shërim të këtij Misteri në çdo kohë sëmundjeje serioze të trupit ose të shpirtit⁸⁸, që të na ndihmojë të jemi të shëndetshëm dhe të padëmtuar për udhëtimin tonë.

Sa herë që humbasim rrugën që na çon te Perëndia (*kur nuk ndjekim shembullin e Jisuit në çdo gjë*), Kisha na thërret në pendim. Nëpërmjet Misterit të RRËFIMIT marrim faljen dhe përtëritjen. Të gjitha mëkatet e rrëfyera, për të cilat jemi penduar vërtet (*duke përfshirë indiferencën ose dembelizmin*), fshihen⁸⁹. Një rrëfim i sinqertë na rikthen stadin e pastërtisë nga mëkatet si një i sapopagëzuar; lindim përsëri prej së larti shpirtërisht dhe kthehemi sërish në udhën e Perëndisë. Në rastin e mëkatit serioz, të një rënieje të madhe, Rrëfimi mund të ketë rezultate shumë të mëdha jetëndryshuese. Ai na jep mundësi të eliminojmë barrierat (*që krijojnë mëkatet*) midis nesh dhe Perëndisë, një mundësi për t'u kthyer përsëri te qëllimi real për jetën.

Nëse në udhëtimin tonë për te Perëndia zgjedhim të kemi një partner (me shpresë që të na ndihmojë në jetën shpirtërore), Kisha ofron Misterin e MARTESËS, për të bekuar dhe shenjtëruar bashkimin tonë⁹⁰. Në një marte-

88 Jakovi 5:13-15

89 Joani 20:23

90 Gjenezë 2:24; Mattheu 19:4-6

së të mirë, të dyja palët përmbushin njëra - tjetrën. Burri dhe gruaja së bashku janë një, në atë mënyrë që nuk është e mundur për asnjërin veç e veç. Plani i Perëndisë fton çiftin në jetë të re në stadin e martesës, që burri dhe gruaja të sigurojnë ushqimin e shpirtit për Mbretërinë e Tij⁹¹.

Ata burra që kanë një thirrje të veçantë nga Perëndia DORËZOHEN për një jetë shërbimi, që të sjellin sa më shumë njerëz te Krishti dhe t'i ndihmojnë të qëndrojnë në grigjën e Tij. Ajo nuk është priftëria Levitike e Dhiatës së Vjetër, e themeluar për t'i ofruar Perëndisë sakrifica shlyese nga njerëzit nën Ligjin e Moisiut. Por priftëria e lartë e Vetë Krishtit, sipas rendit të Melkisedekut⁹²; që është e përjetshme dhe vazhdimisht i ofron mistikërisht Perëndisë të vetmen sakrificë përfundimtare të Gjakut të Krishtit për ndjesën e mëkateve të njerëzimit. Ky prift "mund ta përmbushë këtë shërbesë vetëm se priftëria... nuk është 'e tij' ... por e vetmja dhe e njëjta priftëri e pandarë e Krishtit, i Cili jeton përjetësisht dhe është përjetësisht i plotësuar në Kishë, që është edhe Trupi i Krishtit"⁹³.

91 Gjenezë 1:27-28

92 Gjenezë 14:18; Psalmi 110:4; Hebrenjve 4:14-7:28; Marku 3:14-15; Matheu 28:16-20

93 Alexander Schmemmann: *Eukaristia*, fq. 115

Veç kësaj, Kisha ofron mjetet shpirtërore *të lutjes, kreshmës, adhurimit, shoqërisë dhe njohurisë* (Tradita e Shenjtë, e cila përfshin Shkrimin e Shenjtë, Shkrimet e Etërve të Kishës, Sinodet, Ikonografinë, Liturgjikën etj., të gjitha mjetet që janë dhënë për të ruajtur të vërtetën për Krishtin), për të na ndihmuar në përpjekjen që të rritemi në shenjtëri, për t'u përgatitur për Mbretërisë e Perëndisë.

3. PËRBALLEM ME GJYKIMIN. Secili nga ne do të gjykohet për ato që mësoi dhe kuptoi se çfarë pret Perëndia nga ai dhe sa u përpoq të jetonte sipas tyre⁹⁴. Disave u është dhënë privilegji dhe përgjegjësia për të kuptuar të fshehtat e Perëndisë⁹⁵. Zoti pret që këta të sjellin sa më shumë shpirtra tek Ai dhe të jenë shembuj të jetës sipas Krishtit. Të tjerëve, ndoshta vetëm një rreze shkëlqimi e Dritës së Perëndisë, u mundësoi largimin e pengesave të ngritura nga Satanai. Gjithsecili do të gjykohet me drejtësi nga Krishti, i Cili është i Gjithëditur, plot dashuri dhe i drejtë. Ndërgjegjësimi për faktin se një ditë do të gjykohemi, është bekim, sepse na ndihmon të parandalojmë neglizhencën shpirtërore.

Në njëfarë mënyre do të gjykojmë veten: gjykimi ynë për të tjerët do të përdoret si standard me anë të të cilit

94 Romakëve 2:1-16

95 1 Korinthianëve 2:6-7

do të gjykoheми⁹⁶, dhe kur Libri i Jetës do të hapet (Zbulesa 20:12-13), do të sjellim ndër mend jetën tonë. Nuk do të na tregohet ku do të qëndrojmë në marrëdhënien tonë me Perëndinë, ne *do ta dimë*.

Të pabesët do të kuptojnë se sa i madh ishte shpëtimi që ata refuzuan, sa e madhe dashuria dhe mëshira që braktisën në jetë, dhe për ta, dashuria rrezatuese dhe lavdia e Perëndisë, prej së cilës ata nuk mund të fshihen më, bëhet si një lumë zjarri, i cili derdhet nga lavdia apo froni i Krishtit dhe i fshin ata larg, ndërgjegjja e tyre e merr atë si thëngjill zjarri. Të drejtët marrin një dhe të njëjtin “zjarr” si një ndriçim dhe kuptim të plotë shpirtëror dhe mbushen me gëzim dhe ekzaltim të patregueshëm nga ai, sepse ky zjarr do të jetë për ta rreze nga Dielli i drejtësisë, i Cili do t’i shërojë nga të gjitha ato që atyre u mungojnë dhe ata do të vazhdojnë para e do të rriten në përsosmëri dhe njohuri deri në përjetësi... (Malakia 4:1-2)⁹⁷.

96 Mattheu 7:1-2.

97 Lazar Puhalo: *Shpirti, Trupi dhe Vdekja*, fq. 45.

Nga ata që pretendojnë shpëtimin e menjëhershëm, disa nuk i kushtojnë rëndësi faktit të gjykimit dhe theksojnë Ngjalljen, kur thuhet se të SHPËTUARIT do të ngjallen në Mbretërinë e Perëndisë dhe të PA-SHPËTUARIT do të dënohen⁹⁸. Thënë ndryshe, konsiderohet se nuk do të ketë kohë aktuale të gjykimit për ata që e kanë shpallur veten e tyre “të shpëtuar”, ndërsa të tjerët të dënuar. Por kjo teori është e bazuar në arsyetimin e gabuar sipas botës dhe jo sipas ndriçimit që Perëndia do të dhurojë në Ardhjen e Tij të Dytë. Të tjerë thonë se gjykimi është vetëm për të Shpëtuarit, jeta e krishterë e të cilëve do të caktojë atë që është “e vlefshme për Mbretërinë e Perëndisë” dhe atë që është “e pavlefshme”⁹⁹, duke ndikuar vendin e tyre në Qiell. Por shën Pavli shkruan se *të gjithë ne duhet të dalim përpara gjykatores së Krishtit* dhe i referohet ditës *së frikshme të Zotit* (2 Korinthianëve 5:10-11). A do të ketë ndëshkim në Qiell? Nëse shpëtojmë menjëherë, vetëm duke deklaruar besimin, pse duhet të shqetësohemi për gjykimin dhe vendin që do të kemi në Qiell? Çdo vend në qiell do të jetë një mrekulli më vete¹⁰⁰.

Gjykim do të ketë me të vërtetë, por *nuk duhet të dëshpërohem*. Nuk duhet ta jetojmë jetën në dyshim dhe

98 Jerry Faluell, ed., me Ed Dobson dhe Ed Hindson: “Fenomeni Fundamentalist, Ringjallja e Krishterimit Konservator”, fq. 21.

99 D. Guthrie: *Komentari i ri i Biblës*, fq. 1080.

100 Psalmi 84:10.

në ankth. Kemi *shpresën* e shpëtimit¹⁰¹. Ne e dimë se Perëndia i mban premtimet e Tij dhe, nëse e duam me të vërtetë dhe përpiqemi të jemi pasuesit e Tij, *do të shpëtojmë* (Matheu 24:13). Dita e Gjykimit nuk do të jetë problem për ata që e duan vërtet Krishtin. Ata do të lundrojnë përgjatë procesit duke mos pësuar dënim, por duke kaluar nga vdekja në jetë (Joani 5:24). Kjo e vërtetë na mbush me gëzim të thellë, të brendshëm, pavarësisht nga uljet dhe ngritjet që sjell jeta jonë tokësore¹⁰².

4. MARR SHPËRBLIMIN. Ata që me jetën e tyre kanë treguar besim se Jisui është Biri i Perëndisë së Gjallë, Shpëtimtari i botës (nëse iu është dhënë mundësia për këtë të vërtetë shpëtuese), do të ftohen të hyjnë plotësisht në Mbretërinë e gëzimit të përjetshëm, të përgatitur për ta që nga themelimi i botës¹⁰³. Perëndia do të thërrasë çdonjërin prej tyre me emër dhe do t'u japë Kurorën e Jetës¹⁰⁴ dhe gurin e bardhë me emrin e tij të veçantë të shkruar mbi të. Në atë vend të lumur nuk do të ketë më

101 Romakëve 8:24.

102 “Orthodhoksia beson se shpëtimi është një realitet pozitiv, më shumë sesa një realitet negativ: shpëtimi është jeta në kungim me Perëndinë, më shumë sesa çlirim nga vargonjtë e djallit dhe pushtetit të tij të mëkatit, vdekjes dhe prishjes”. Maksim Agjiorgusis.

103 Matheu 25:34.

104 Jakovi 1:12; Zbulesa 3:5.

as vdekje, as shqetësim, as qarje dhe as dhimbje¹⁰⁵. Mbretëria fillon në këtë jetë për ata të krishterë të pagëzuar, të cilët ia përkushtojnë jetën e tyre Krishtit, sepse jetojnë me gëzimin e njohjes së sigurisë së premtimeve të Perëndisë. Sapo fillon përjetimin e besimit, në fakt, besimtari shijon Mbretërinë e Perëndisë, edhe pse është ende në tokë. Sa më shumë që të mohohet jeta e botës, aq më shumë lulëzon jeta shpirtërore dhe shijohen frytet e saj (Galatianëve 5:22).

“Ashtu sikurse ligësia tenton të dënojë ata që e ndjekin atë edhe përpara se ata të arrijnë në gropë, kështu edhe virtyti, para dhuratës së Mbretërisë, u siguron ndriçim atyre që e praktikojnë atë në tokë, ndërsa ata jetojnë në shoqërinë e shpresave të mira dhe të gëzimit të vazhdueshëm.” (Shën Joan Gojarti)¹⁰⁶

Perëndia na krijoi të jetojmë përjetësisht, dhe kështu do të jetë, në një gjendje ose në një tjetër. Jeta e atyre që nuk kanë treguar besim te Krishti (sërisht sipas mundësisë) do të jetë ankth i përjetshëm me Satanain dhe pasuesit e tij¹⁰⁷, të larguar nga *prania e Perëndisë dhe lavdia e fuqisë së Tij* (2 Thesalonikasve 1:9).

105 Zbulesa 21:4

106 Schaff: *Fjalimi XL*, fq. 147

107 Mattheu 25:41

Ne nuk mund ta imagjinojmë dot se si do të jetë të qenit larg kësaj Lavdie të Bekuar, të mos njihemi nga Krishti, dhe të dëgjojmë *nuk ju njoh* (Mattheu 25:12). Shën Joan Gojarti¹⁰⁸

Ky nuk është dënim i dhënë nga Perëndia, por është pasojë e mohimit të Tij¹⁰⁹. Marrim atë që kemi zgjedhur.

ENGUSHTË ËSHTË DERA *dhe e vështirë udha që çon në jetë, dhe të paktë janë ata që e gjejnë atë* (Mattheu 7:14). Përpjekja për të jetuar një jetë si e Krishtit, mund t'i përngjasojë një ngjitjeje në mal. Duke ecur nëpër gëzimet dhe hidhërimet e jetës, destinacioni ynë është hyrja e ngushtë në plotësinë e Mbretërisë së lavdishme të Perëndisë. Ne e kemi nisur këtë rrugë në Pagëzim, me sytë e ngulitur te Shpëtimtari ynë. Shpirti i Shenjtë na motivon me dashuri gjatë gjithë jetës, sipas masës së dashurisë dhe besimit tonë. Mjetet e dhëna nga Kisha na ndihmojnë përgjatë udhëtimit, me Pendim dhe Rrëfim të sinqertë duke na ripërtërirë dhe duke na vendosur përsëri në udhën e duhur kur jemi larguar.

Jemi të gjithë të ndryshëm. Secili nga ne e fillon ngjitjen në rrethana të ndryshme. Disa gëzojnë

108 Schaff: *Fjalimi XXII për Mattheun*, fq. 164.

109 Joani 12:48.

atmosferën e dashurisë, udhëzime të pjekura dhe rehati materiale. Të tjerë luftojnë me mungesën e gjithçkaje. Disa janë të bekuar me një tokë pjellore shpirtërore, në të cilën rriten dhe fillojnë procesin më herët; ndërsa shpirtra të tjerë hapin gojën për frymë në një djerrinë shpirtërore dhe nuk janë zgjuar për jetën me Perëndinë deri në stadet e fundit të jetës së tyre. Të gjitha rastet janë të mundshme. Përderisa nuk na janë dhënë të njëjtat bekime për udhëtimin tonë gjatë jetës, Perëndia nuk pret të njëjtat fryte nga secili. Me vullnet të lirë, secili prej nesh është i aftë t'i përgjigjet Perëndisë në mënyrën e tij unike. Ai kërkon, për të mirën tonë, që atë që na është dhënë, ta përdorim në shërbim të Tij¹¹⁰, në përputhje me fjalën e Tij. Prej kësaj do të gjykohe mi.

Nuk ka rëndësi se sa lart na ka çuar përpyekja në udhën e përsosjes, e rëndësishme është të kemi dashuri për Perëndinë dhe besim te Biri i Tij si Shpëtimtar dhe të përpiqemi me të vërtetë të vazhdojmë ngjitjen deri në fund të jetës sonë.

Perëndia nuk premton se jeta do të jetë e lehtë. Ai premton se do të jetë me ne, do të na drejtojë, do të na forcojë dhe do të na ndihmojë për ta përfunduar udhëtimin¹¹¹. E ndiejmë dashurinë e Tij nëpërmjet për-

110 Romakëve 12:4-8.

111 Mattheu 28:20; 2 Korinthianëve 1:3-5.

jetimeve të Mbretërisë, të cilat janë kaq të lavdishme dhe të fuqishme, saqë gjithmonë kemi etje për më shumë. Nganjëherë këto përjetime na jepen nëpërmjet një ndërgjegjësimi për madhësitë e krijimit të Perëndisë, duke menduar madhësitë e lavdishme që na pret në Qiell¹¹². Këto përjetime mund të na jepen gjithashtu në periudha vuajtjesh, kur ndërgjegjësohemi për varësinë tonë të plotë nga mëshira e Perëndisë, për sa i përket gjërave që kanë vërtet vlerë, dhe kur i kuptojmë aftësitë tona të kufizuara, fillojmë të ndiejmë praninë e Tij që na mbush dhe na ngushëllon¹¹³.

112 Romakëve 1: 19-20.

113 2 Korinthianëve 1:8-10.

Shën Efrem Siriani

GËZIMI I HYRJES NË MBRETËRI

DHE AGONIA E TË QENIT I PËRJASHTUAR

Çfarë gëzimi do të na pushtojë nëse drejtohem në anën e djathtë të Mbretit? Si do të ndihemi kur i Drejti të na përqafojë atje?... Abrahami, Isaaku, Jakovi, Moisiu, Noeja, Jovi, Danieli, Profetët e shenjtë, Apostujt, Martirët, të cilët i pëlqyen Perëndisë kur jetuan në tokë. Dhe për cilindo që keni dëgjuar, jetën e të cilëve e keni admiruar, dhe ata që tani dëshironi t'i shikoni, do të vijnë te ju, do t'ju përqafojnë dhe do të gëzohen për shpëtimin tuaj. Çfarë lloj njeriu duhet të jemi? Si do të jetë ai shkëlqim i pashprehur të cilin do ta marrim, kur Mbreti me gëzim do t'u thotë atyre që do të jenë në të djathtën e Tij: *"Ejani të bekuarit e tim Eti, trashëgoni mbretërinë që është bërë gati për ju qëkurse është themeluar bota"* (Mattheu 25:34)?

Atëherë, do të merrni nga Dora e Zotit Mbretërinë e bukurisë, Kurorën e gjithë dëshirave tuaja, dhe do të mbretëroni me Krishtin përgjithmonë. Pastaj do të merrni për trashëgim dhuratat që Perëndia u ka premtuar atyre që e duan dhe i shërbejnë Atij (Jakovi 1:12). Që nga ai moment e më pas do të jeni të sigurt dhe nuk do të jeni më të mbushur me ankth. Arsyeto se çfarë lloj personi duhet të jetë ai të cilit do t'i jepet të mbretërojë me Krishtin në Qiell! Reflekto se çfarë do të thotë të jetosh

përjetësisht në dritën e Pranisë së Tij dhe të zotërosh burimin e dritës!

“Dielli nuk do të jetë më drita jote gjatë ditës, as hëna nuk do të të ndriçojë më me vezullimin e saj” (Isaia 60:19), por Krishti do të jetë drita jote e paperënduar dhe Perëndia lavdia jote. Ja çfarë lavdie ka përgatitur Ai për ata që ia kanë frikën, duke respektuar Urdhërimet e Tij!

Pastaj mendoni për fundin e mëkatarëve, ndërsa ata shkojnë para gjykatores së frikshme. Çfarë tmerri do t’i zërë në praninë e Gjykatësit të drejtë, duke mos pasur asnjë mënyrë për t’iu shmangur pranisë së Tij?! Çfarë turpi do t’i zërë, ndërsa drejtohen nga ana e majtë e Mbretit?! Çfarë shije të hidhur do të përjetojnë, kur Ai, në hidhërimin e Tij, do t’u thotë atyre dhe do t’i mendojë ata në zemërimin e Tij duke iu thënë: *“Ikni prej meje, të mallkuar, në zjarr të pasosur, që është bërë gati për djallin e për engjëjt e tij”* (Mattheu 25:41)¹¹⁴?

114 Toal, vol. 1, fq. 13.

Shën Grigori i Madh

**KUJDESUNI TË MOS GJYKONI VETEN
OSE TË TJERËT**

Të shumtë janë ata që e njohin besimin, por të paktë janë ata që hyjnë në Mbretërinë e Qiellit. Të shumtë janë ata që i shërbejnë Perëndisë me gjuhën e tyre, por i largohen Atij me jetën e tyre. Prandaj duhet të reflektojmë për dy gjëra: së pari, askush nuk duhet të hamedësojë për shpëtimin personal, sepse, edhe pse e njohu besimin, nuk e di nëse do të jetë i zgjedhur për të hyrë në Mbretërinë e Qiellit dhe, së dyti, askush nuk duhet të dëshpërohet për të afërmin që e shikon të zhytur në ves, sepse askush nuk e di pasurinë e mëshirës hyjnore¹¹⁵.

¹¹⁵ Ibid, fq. 365

Hapi i katërt: Mbretëria e Perëndisë

IKONA E ZBRITJES SË KRISHTIT NË HADH



Kjo ikonë thekson hapin e katërt në procesin e shpëtimit: "Marrja e Shpërblimit". Do të marrim atë që kemi zgjedhur. Ata që treguan me jetën e tyre besimin te Krishti si i Vetmi që u tregoi udhën për t'u bashkuar sërish me Perëndinë, do të marrin jetën e përhjetshme me Të në Mbretërinë e Tij.



Ndërsa Trupi i Jisu Krishtit ishte vendosur në Varr, Shpirti i Tij zbriti në Hadh (1Pjetri 4:6 dhe Efesianëve 4:9-10), që t'u jepte atyre që kishin jetuar dhe vdekur para Tij, vdekjen e Tij shpëtimtare dhe çliruese nga skllavëria e Satanait dhe mundësinë ta njihnin e ta pranonin si Mesian e profecive të Dhiatës së Vjetër. Prandaj ikona e Zbritjes së Krishtit në Hadh (e njohur edhe si ikona e Ngjalljes), përshkruan Adamin dhe Evën (që përfaqësojnë njerëzimin) duke u çliruar nga agonja e vdekjes. Figura që tregohet me pranga në errësirë në fund të ikonës është djalli, duke ilustruar faktin se fuqia e tij tashmë është shkatërruar. Ai e kishte mbërthyer njerëzimin me anë të vdekjes, por “thumbi” tashmë u largua, edhe pse njeriut ende i duhej të kalonte nëpërmjet vdekjes (*deri në Ardhjen e Dytë*), ajo nuk mund t'i mbajë më ata që vdesin duke i besuar Krishtit si Shpëtimtar. Përreth Krishtit ka personazhe biblike që jetuan dhe vdiqën para se Vdekja e Tij të hapte dyert e Parajsës. Në të djathtë të Tij janë Mbretërit, David e Solomon, dhe Joan Pagëzori; në të majtë, Abeli (i cili parafiguroi Krishtin) dhe profetët¹¹⁶.

116 Photios Kontoglou, *Ekphrasis*, fq. 180.

Kur zbrite te vdekja, Ti, o jeta e pavdekur,
atëherë Ferrin e vdiqe me shkëlqimin e
Hyjnisë; dhe kur ngrite të vdekurit nga
fundet e dheut, gjithë fuqitë qiellore të
thërrisnin: Jetëdhënës Krisht, Perëndia ynë,
lavdi më Ty.

Nga Mëngjesorja e së Shtunës së Madhe

Me trupin në varr, me shpirtin në ferr si
Perëndi, në Parajsë me kusarin dhe në fron
bashkë me Atin e me Shpirtin ishe, o Krisht,
Ti i papërshkruar; që i mbush të gjitha.

Nga Shërbesa e Proskomidhisë

EPILOG

A JE I SHPËTUAR? Kjo pyetje duhet të jetë preokupim parësor për të gjithë ata që kanë marrë dhuratën e jetës. Qëllimi i këtij libri është përpjekja për të siguruar, sipas termave laikë, një skicim të Planit hyjnor të Perëndisë për “njerëzit” e Tij të dashur, që ata të cilët kërkojnë njohuri për qëllimin e jetës të udhëhiqen nga e Vërteta e përjetshme e Perëndisë.

Mesazhi i shpëtimit nëpërmjet Birit të Perëndisë është për çdo njeri. Ai është i thjeshtë dhe gjithëpërfshirës. Duhet të dëgjohet nga të gjithë dhe të mësohet përsëri e përsëri në shtëpitë dhe kishat tona, në çdo nivel të të kuptuarit njerëzor. Ai duhet të përshkojë çdo fushë të jetës sonë dhe të udhëheqë çdo vepër dhe vendim tonin.

Mendimet që parashtrohen në këtë libër nuk janë të reja, ato janë predikuar nga Kisha e hershme që në kohën kur Jisu Krishti u ngjiti në Qiell për të pritur ata që e duan Atë. Lutemi që ky tekst të na ndihmojë të kuptojmë atë që Krishti ka bërë për ne dhe kështu të na frymëzojë t’i përkushtohemi ose të ripërtërijmë vazhdimisht përkushtimin tonë serioz e jetëdhënës ndaj Tij, si Zot dhe Shpëtimtar. Le të punojmë të gjithë së bashku,

të ndajmë këtë njohuri jetëdhënëse me të gjithë ata që do ta dëgjojnë, dhe të gjithë të vazhdojmë të rritemi në ngjashmërinë e Tij, që të tregojmë besimin dhe dashurinë tonë për Të dhe të përgatitemi për shenjtërinë e Mbretërisë së Tij.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Pappas, Barbara

A je i shpëtuar? : Procesi i shpëtimit në Kishën Orthodhokse:
përkth. / Barbara Pappas; red. Rozeta Baba. - Tiranë: Kisha
Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 2017

82 f. ; 14 x 20.5cm.

Tit. origj.: Are you saved?

ISBN 978-9928-4377-5-4

1. Kisha Ortodokse 2. Shpëtimi

271.2 -185.5